

VENDIM
Nr. 167, datë 18.10.2016

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ANKANDIT TË ZYRËS SË KOORDINUAR TË ANKANDEVE PËR EVROPËN JUGLINDORE (SEE CAO) VERSIONI 1.4

Në mbështetje të neneve 16 dhe 65, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike, nenit 26 dhe 37, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.10.2016, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur dhe të rënë dakord nga (SEE CAO) dhe TSO-të aksionerë të saj, të Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore (SEE CAO) versioni 1.4, dhe relacionin përkatës,

Konstatoi se:

- Sekretariati i Energjisë (Vjenë, Austri) dhe mbledhja 11-të e ECBR-së mbajtur me datë 9.7.2009, rekomandon që rregullatorët kombëtarë të miratojnë rregulloret e aprovuara nga SEE CAO.

- Rregullorja është e hartuar në përputhje me kërkesat e rregullores (KE) 714/2009 të Parlamentit Evropian.

Shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 4855 prot., datë 25.8.2016, ka dërguar në ERE propozimin për miratim të Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore (SEE CAO) 1.4.

- Me vendimin nr. 153, datë 30.9.2016, Bordi i ERE-s filloi procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e rregullave të ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore SEE CAO (bashkëlidhur draft "Rregullat e ankandit, versionin 1.4).

- Për këtë vendimarrje u njoftuan palët e interesit, si dhe u ftuan që të shprehnin opinionet e tyre brenda datës 20.10.2016.

- OST-ja, me shkresën e saj nr 6358/1, datë 12.10.2016, mbështetur në nenin 37 të "Rregullores së funksionimit dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s 96, datë 17.6.2016, ka kërkuar përshpejtimin e procesit të vendimarrjes nga Bordi i ERE-s, me qëllim që kjo vendimarrje të mos bëhet pengesë për zhvillimin e ankandeve.

- Ndryshimet e kësaj rregulloreje nga versionin më herët i miratuar nga ERE CAO 1.3, janë të formës, pa cenuar përmbajtjen, pra lidhen kryesisht me përmirësime të gjuhës së shprehur të parashikimeve të kësaj rregullore.

- Autoriteti i Konkurrencës më herët me shkresën nr. prot. 359/1, datë 7.9.2015 ka bërë me dije se "Rregullorja" nuk bie ndesh me ligjin nr. 9171, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar.

- Shqyrtimi i përshpejtuar i kësaj praktike nuk parashkruan asnjë të drejtë të palëve të interesuara për ta ankimuar vendimarrjen e ERE-s.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregullat e ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore SEE CAO Versioni 1.4 (bashkëlidhur "Rregullat e ankandit", në gjuhën origjinale angleze dhe në shqip).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsu-matorit të njoftojë personat e interesuar për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

Zyra e Koordinimit të Ankandëve në Evropën Juglindore

Rregullorja e ankandit për alokimin e kapaciteteve në SEE CAO

(me poshtë “**Rregullorja e ankandit**”)

Versioni 1.4



Podgorica, Mal i Zi
Gusht 2016

Faqe e bardhë e lënë me qëllim

Përkufizimet:

Termat dhe shkurtesat e përdorura në Rregulloren e Ankandit kanë kuptimin si më poshtë:

PTR e alokuara	PTR e rezervuara të fituara në ankandet vjetore ose mujore për të cilat pagesa është kryer në përputhje me Rregulloren e Ankandit.
Kalendari i Ankandëve	Skedulimi i ankandëve vjetore dhe mujore dhe i pagesave. Kalendari i Ankandëve është publikuar në faqen e internetit të SEE CAO-së www.seecao.com .
Pjesëmarrës i Ankandit	Një person juridik që merr pjesë në Ankand, i regjistruar në SEE CAO në përputhje me nenin 3.1.
Proçesi i Ankandit	Ankand eksplicit i përdorur për rezervimin e PTR-ve në harkun kohor mujor dhe vjetor ose për alokimin e PTR-ve në harkun kohor ditor, të kryer nga SEE CAO.
Specifikimet e Ankandit	Specifikimet e veçanta të një ankandi, përfshirë informacionin e përcaktuar në nenin 5.2.
Platforma e Ankandit	Zgjidhje IT, të dyja hardware dhe software, për kryerjen e proçesit të ankandit.
Sistemi i kohës i Platformës së Ankandit	Specifikimi i një date dhe kohe, duke përdorur anëtarët e veçantë për muajin, ditën, vitin, ditë javë, orë, minutë, sekonda dhe milisekonda. Koha është e përfaqësuar në CET (UTC + 1).
Garanci Bankare	Një garanci bankare, sipas kërkesës, e pakushtëzuar dhe e parevokueshme, e lëshuar nga një institucion krediti, dhe e kërkuar nga SEE CAO për tu plotësuar nga Pjesëmarrësi i Ankandit për pjesëmarrje në Ankand. Garanci bankare duhet të lëshohet nga një institucion që plotëson kërkesat e përcaktuara në Aneksin 6 dhe duhet të përputhen me Shtojcën 1 të Aneksit 6. Ajo konsiderohet pjesë e Limitit të Kreditit.
Ofertë	Kërkesa për rezervimin e PTR përbërë nga sasia e ofertës dhe çmimi i Ofertës paraqitur për një çift të caktuar

	Marrës-Dhënës.
Çmimi i Ofertës	Pjesa e ofertës që përfaqëson çmimin e shprehur në € / MWh, dhe të cilën pjesëmarrësi i Ankandit është i gatshëm ta paguajë për rezervim/alokimin e PTR.
Vlera e ofertës	Produkti i dalë nga sasia e ofertës, çmimi i ofertës dhe kohëzgjatja e produktit në fjalë në orë, i shprehur në Euro.
Sasia i ofertës	Sasia e PTR-së në MW kërkuar nga një Pjesëmarrës i Ankandit.
Marrëveshja e Identifikimit të Kapacitetit(CAI)	CAI është një identifikim unik, i caktuar nga zyra e ankandit secilës PTR përgjatë Proçesit të Ankandit ose Proçesit të Transferimit të PTR-së dhe do të përdoret për të gjitha referencat ndaj PTR-së.
CET	Central European Time.
Kompesim	Vlera monetare që i paguhet, një pjesëmarrësi ankandi për PTR e alokuara, të kthyera (për rishitje dhe UIOSI), si çmim nga ankandi përkatës.
Zonë Kontrolli (CA)	Pjesë e sistemit të ndërlidhur të transmetimit të kontrolluara nga një OST.
Limiti i kreditit	Shuma në euro, e barabartë me vlerën e të gjitha instrumenteve të menaxhimit të rrezikut të siguruara nga Pjesëmarrësi përkatës i Ankandit dhe të pranuar nga SEE CAO, e cila përbën kufirin maksimal për vlerën e PTR-ve që mund ti caktohen Pjesëmarrësit përkatës të Ankandit në proçesin e ankandit.
Reduktimet	Reduktimi i PTR-së së alokuar në rast situatë emergjente dhe / ose të Forcës Madhore, ku OST duhet të veprojnë në një mënyrë të shpejtë dhe ku rishpërndarja apo shkëmbimi kompesues nuk është i mundur.
Oferta të paracaktuara	Oferta e identifikuar nga Pjesëmarrësi në Ankand në Platformën e Ankandit e cila aplikohet automatikisht në secilin proçes pasues Ankandi.
Depozitë	Shuma e parave, të depozituara nga Pjesëmarrësi i Ankandit, në llogarinë e hapur nga SEE CAO në emër të tij, prej të cilës, SEE CAO do të mbledhë borxhet e krijuara si rezultat i mos-pagesës së PTR-së së alokuar. Ajo

	është konsideruar pjesë e Limitit të Kreditit së bashku me ose si një alternativë e garancisë bankare.
D	Dita në të cilën bëhet transmetimi/shpërndarja e energjisë elektrike.
D-1	Dita përpara ditës kalendarike (D) në të cilën bëhet i mundur transmetimi / shpërndarja e energjisë elektrike
D-2	Dita, dy (2) ditë kalendarike para ditës (D) në të cilën bëhet i mundur transmetimi / shpërndarja e energjisë elektrike.
Kodi EIC	Skema e Kodimit të identifikimit të Energjisë e ENTSO-E për identifikimin e subjekteve në një tregti ndërkufitare.
Gjendja e jashtëzakonshme	Kushte dhe/ose ngjarje, dhe/ose rrethana, në të cilat përmbushja e detyrimeve nga SEE CAO-së dhe/ose nga OST-të pjesëmarrëse bëhet e pamundur, pjesërisht e pamundur ose shumë e vështirë. Në veçanti kjo i referohet shteteve në të cilat një operim i sigurt dhe i qëndrueshem i një Zone/a të caktuar/a Kontrolli/t është i rrezikuar. Gjendja e jashtëzakonshme mund të jetë gjithashtu një rezultat i Forcës Madhore duke u bërë shkak për mbingarkesë të elementeve kritike të rrjetit, mospërmbushjes së kriterit n-1, problem të stabilitetit, probleme me tensionin, probleme balancimi në të cilën OST-ja pjesëmarrëse nuk është në gjendje për të balancuar Zonën e saj të Kontrollit.
Pjesëmarrës të ligjshëm në Ankand	Një Pjesëmarrës Ankandi i cili i plotëson kushtet e vendosura nga rregullimet kombëtare të OST-ve pjesëmarrëse përkatëse për dorëzimin e ofertave për një produkt të veçantë, dmth: çifti marrës-dhënës.
Procedura e Sigurisë (Fallback mode)	Proçesi që zbatohet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin 5.9, 5.10, 8.5 dhe 9.5 në rastin e mos disponibilitetit të Platformës së Ankandit.
Forcë Madhore	Kuptimi është përcaktuar në nenin 17.8.
Kontrata Kornizë	Kuadri Ligjor ndërmjet SEE CAO-s dhe Pjesëmarrësit të Ankandit, e cila udhëheq, ndër të tjera, pjesëmarrjen e këtyre të fundit në Ankand, e përbërë nga këto Rregulla Ankandi dhe Deklarata e Pranimit, e plotësuar në mënyrë të rregullt dhe e nënshkruar sipas konfirmimit të bërë nga
Të drejtat e	

Transmetimit Afatgjatë	SEE CAO. PTR-të e alokuara në Proçesin e Ankandit Muor dhe Vjetor.
Mbyllja e portës	Momenti në të cilin Ankandi ka përfunduar dhe çdo Pjesëmarrës Ankandi nuk ka më mundësi të paraqesë oferta për atë Ankand.
Hapja e portës	Momenti në të cilin Proçesi i Ankandit fillon dhe çdo Pjesëmarrës Ankandi mund të paraqesin ofertat e tyre.
Indikacioni "Të gjitha ose asgjë"	Tregues nëse çdo element i ofertës mund të jetë apo jo marginal. Kjo do të thotë se sasia e ndarë për çdo element të ofertës mund të jetë çdo gjë në mes të 0 dhe sasisë së kërkuar. Nëse nuk është i ndashëm, sasia mund të jetë vetëm 0 ose sasia e kërkuar. Kjo është e aplikueshme vetëm për ofertën e fundit të pranuar. Nëse kapaciteti i ofruar është arritur, e ndashme do të thotë se ajo mund të reduktohet deri në Kapacitetin e Ofruar dhe si rrjedhojë është pjesërisht i pranuar.
Specifikimet fillestare të Ankandit	Specifikimet e veçanta të Ankandit muor përpara se rishitja të aktivizohet.
Interkoneksion	Seti i linjave me një dhe/ose dy qarqe midis sistemeve të transmetimit të Zonave të Kontrollit.
Çmimi marxhinal	Çmimi i ofertës, më i ulët, i pranuar për një Produkt në një Ankand (shih nenin 7.1).
Pjesëmarrës i Tregut	Nënkupton pjesëmarrësin e tregut siç përcaktohet në Rregulloren (EU) Nr 1227/2011 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 25 Tetorit 2011 për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë.
(NTC) Kapaciteti Neto i Transmetimit	Kapaciteti maksimal për shkëmbim ndërmjet dy Zonave të Kontrollit në përputhje me standartet e sigurisë të aplikueshme në të dy këto Zona Kontrolli.
Siguria e Rrjetit	Shkalla/Masa në të cilën Rrjeti mund të operojë normalisht, duke kufizuar numrin e incidenteve, duke shmangur incidente të mëdha dhe kufizuar pasojat që vijnë.
Kapaciteti i ofruar	Kapaciteti i ofruar në Ankand nga SEE CAO për një çift marrës-dhënë, të dhënë për një periudhë të caktuar kohore në Ankand.

OST-të pjesëmarrëse	OST-të që janë aksionerë të SEE CAO sipas aneksit 2.
Palë	SEE CAO ose një Pjesëmarrës Ankandi.
Palët	SEE CAO dhe Pjesëmarrës Ankandi së bashku.
Të drejtat fizike të Transmetimit (PTR)	E drejta për të përdorur kapacitetin ndërkufitar të energjisë elektrike e shprehur në MW në çiftin përkatës marrës-dhënës.
Produkt	Kapacitete të plota ose të pjesëshme, të ofruara, vjetore, mujore ose ditore në çiftin përkatës marrës-dhënës
Programi i Shkëmbimit	Nominimi i pranuar i PTR-së së alokuar sipas dispozitave të përcaktuara në këtë Rregullore Ankandi dhe procesi i përputhjes i kryer nga OST-të përkatëse.
Rimbursim	Paratë që i kthehen mbrapsht Pjesëmarrësit në Ankand për PTR-të e alokuara të cilat janë humbur për shkak të reduktimit të PTR-ve të alokuara (çmimi origjinal).
Rishitje	Mekanizmi me të cilin një Pjesëmarrës Ankandi kthen PTR-të vjetore të alokuara tek OST-ja përkatëse nëpërmjet SEE CAO për tu rishitur në një Ankand Mujor.
PTR e rezervuar	Me njoftimin e rezultateve prej Ankandëve vjetore dhe/ose mujore, Pjesëmarrësi i Ankandit siguron PTR-në e rezervuar. Me kryerjen e pagesës, PTR e rezervuar kthehet në PTR e alokuar.
Tregu Sekondar	Shërbim i cili mundëson transferimin dhe rishitjen siç është përshkruar respektivisht në Paragrafin 8 dhe 9.
Proçesi i Skedulimit	Proçesi i nominimit të Programit të Shkëmbimeve të OST-së në fjalë.
SEE CAO	Zyra e Koordinuar e Ankandëve në Europën Jug-lindore.
Secure Sockets Layer (SSL)	Teknologji e sigurisë standarte për krijimin e një lidhje të koduar në mes të një server dhe një klienti.
Marrës CA	Zonë Kontrolli, në të cilën Programi i Shkëmbimit është nominuar si një import.
Dhënës CA	Zonë Kontrolli, në të cilën Programi i Shkëmbimit është nominuar si një export.
Çifti marrës-dhënës	Pala e Marrësit CA dhe dhënësit CA që tregon një drejtim

	të shkëmbimit të energjisë midis dy zonave fqinje të Kontrollit.
Deklaratë Pranimi	Deklarata me të cilën një person juridik merr përsipër të veprojë në përputhje me termat dhe kushtet e përmbajtura në Rregulloren e Ankandit (shih Shtojcën 4).
Vula e kohës	Sistemi kohor i Platformës së Ankandit jep një mesazh që përkon me kohën e hyrjes dhe/ose daljes në Platformën e Ankandit.
Transferim	Mekanizmi me të cilin një Pjesëmarrës Ankandi mund të transferojë PTR-në e tij të alokuar një Pjesëmarrësi tjetër në Ankand (Marrësit).
Marrës	Pjesëmarrës Ankandi që fiton PTR-në e alokuara si rezultat i një Transferimi.
UIOSI	Principi Përdore ose Shite
Transferuesi	Pjesëmarrës Ankandi që kryen një Transferim tek Marrësi.
OST (Operatori i Sistemit të Transmetimit)	Do të thotë një entitet fizik dhe juridik, përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjes, zhvillimin e sistemit të transmetimit në një zonë kontrolli të caktuar kur kjo e fundit është e nevojshme dhe, ku është e mundshme, ndërlidhjen e këtij sistemi me sisteme të tjera, me qëllim sigurimin e mundësive afatgjata të sistemit dhe përmbushjen e kërkesave të arsyeshme për shpërndarjen e energjisë elektrike.
Përdorues	Një individ që ka të drejtë për të përdorur Platformën e Ankandit
Ditë Pune	Ditët kalendarike nga e Hëna deri të Premten me përjashtim të festave publike të Malit të Zi (shih Kalendarin e ankandeve të publikuar në faqen e internetit të SEE CAO (www.seecao.com)).

Paragrafi I- Hyrje

Neni 1.1 Vlerësim i përgjithshëm

1. Në përputhje me kërkesat e Rregullores (KE) 714/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi kushtet për hyrjen në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike, dhe Traktatit të Komunitetit të Energjisë, kjo Rregullore Ankandi përcakton termat dhe kushtet që rregullojnë shpërndarjen e kapacitetit ndërkufitar nëpërmjet Proçeseve të Ankandit në të dyja drejtimet ndërmjet Zonave të Kontrollit të OST-ve Pjesëmarrëse siç tregohet në Aneksin 3.
2. Proçesi i ankandit nuk është një aktivitet i motivuar nga ana tregtare, por ka qëllim të ofrojë një metodë transparente me bazë tregtare të menaxhimit të kongestionit.
3. Për të lehtësuar tregun në rajonin e SEE, OST-të Pjesëmarrëse, vendosën të krijojnë një Zyrë të Koordinuar të Ankandeve.
4. Kapacitetet ndërkufitare alokohen nëpërmjet Proçesit të Ankandit në formën e të Drejtave të Transmetimit Fizik (PTR) në baza vjetore, mujore dhe ditore.
5. Proçesi i Ankandit ka lidhje vetëm me PTR-në. Pjesëmarrësit e Ankandit nuk mund të thërrasin asnjë të drejtë tjetër përveç PTR-së të vënë në dispozicion të tyre në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë Rregullore Ankandi.

Neni 1.2 Aspekte të përgjithshme të Rregullores së Ankandit

1. Pjesëmarrësi i Ankandit është i detyruar të respektojë këtë Rregullore Ankandi që nga përfundimi i Kontratës Komizë, psh. që në momentin që SEE CAO merr vërtetim të pranimit të nënshkruar në mënyrë të rregullt të plotësuar nga Pjesëmarrësi i Ankandit.
2. Kjo Rregullore Ankandi përshkruan kërkesat që Pjesëmarrësi i Ankandit duhet të përmbushë në mënyrë që të marri pjesë në Proçeset vjetore, mujore dhe ditore të ankandit, dhënien e PTR-ve, kushtet për të hyrë në Tregun Sekondar dhe shfrytëzimin e PTR-ve të alokuara.

3. Rregullorja e Ankandit anullos dhe zëvendëson të gjitha rregullat e mëparshme të ankandit, të cilat më parë bënin alokimin e kapacitetit ndërkufitar në kombinime të caktuara dhe korniza kohore të përmendura në Aneksin 3.
4. Rregullorja e Ankandit nuk e rregullon hyrjen në rrjet të OST-ve. Hyrja në rrjet është garantuar në përputhje me rregulloren e brendshme.
5. Në rast të ndonjë mospërputhjeje mes Rregullores së ankandit dhe marrëveshjeve specifike për nominimin e kapaciteteve, për çështjet që lidhen me zbatimin e procesit të ankandeve dhe Tregun Sekondar në interkoneksionet përkatëse, përparësi do të ketë Rregullorja e Ankandit.

Neni 1.3 SEE CAO

1. OST-të pjesëmarrëse së bashku themeluan SEE CAO-n, e cila ju ofron atyre një shërbim të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve. SEE CAO është përgjegjëse ndaj OST-ve pjesëmarrëse për të kryer procesin e ankandit në përputhje me Rregulloren e Ankandit e cila bazohet, ndër të tjera, në Rregulloren e KE-së 714/2009.
2. SEE CAO do të kryejë Proçeset e Ankandit, por në emër dhe për llogari të OST-ve pjesëmarrëse.

Neni 1.4 Kualifikimet e përgjithshme ligjore, të drejtat dhe detyrimet

1. Në bazë të kësaj Rregulloreje Ankandi, do të ketë vetëm një lidhje kontraktuale midis SEE CAO-s dhe Pjesëmarrësit të Ankandit. SEE CAO është i detyruar ti vejë në dispozicion PTR-në e alokuar Pjesëmarrësit të Ankandit, ndërsa këta të fundit janë të detyruar të përmbushin detyrimet e tyre të pagesës në bazë të të drejtave të dhëna (PTR).
2. Pjesëmarrësit e OST-ve janë të angazhuar në drejtim të SEE CAO-s për të vënë kapacitetin ndërkufitar në dispozicion të Pjesëmarrësit të Ankandit si PTR-të, me përjashtimet e përshkruara në nenin 2.3, të pranojnë rezultatet e Proçesit të Ankandit të kryer nga SEE CAO dhe të rezervojnë kapacitetet transmetuese në mënyrë që të bëjë të mundur përdorimin e PTR-ve nga Pjesëmarrësi i Ankandit.
3. PTR-të do të alokohen në përputhje me rezultatet e Proçesit të Ankandit, përveç në rast Shkurtimeve të përshkruara në nenin 2.3.
4. Bazuar në rezultatet e Proçesit vjetor dhe/ose mujor të ankandit, Pjesëmarrësi i Ankandit merr PTR-në e rezervuar. PTR e rezervuar do të bëhet PTR e

alokuar sapo pagesa në përputhje me nenin 11 të bëhet nga Pjesëmarrësi i Ankandit. Në Proçeset e ankandeve ditore, PTR ju alokohet Pjesëmarrësve të Ankandit sipas njoftimit të rezultateve të Proçesit të Ankandit.

Paragrafi 2 . Të përgjithshme

Neni 2.1 Ankandet vjetore, mujore dhe ditore

1. Proçeset e Ankandit për alokimin e kapaciteteve të ofruara janë implementuar me anë të ankandeve eksplicite në përputhje me nenin 5, në të gjitha kombinimet e çiftit marrës-dhënës, (shih Aneksin 3), në çdo drejtim dhe për disa harqe kohore, në mënyrë për të alokuar kapacitetet e ofruara për Pjesëmarrësit e Ankandit.

2. Proçesi i Ankandeve drejtohet në këto harqe kohore:

- a. Proçesi vjetor i Ankandit, me Produkte në dispozicion nga 1 Janari deri më 31 Dhjetor në vitin përkatës kalendarik, ose në rast të periudhës së mirëmbajtjes, me Produkte në dispozicion për periudha më të vogla që mbulojnë vitin kalendarik. Në Proçeset vjetore të ankandit PTR-të janë hedhur në ankand me shumën bazë të MW në orë, përveç në rastet e periudhës së mirëmbajtjes. Për Proçesin vjetor të ankandit, llogaritja e rezultateve të ankandit është bërë në të njëjtën kohë në të gjitha kombinimet e çiftit marrës-dhënës një herë në vit.
- b. Proçesi mujor i Ankandit, me Produktet në dispozicion nga dita e parë deri në ditën e fundit të muajit përkatës kalendarik, ose, në rast të periudhës së mirëmbajtjes, me Produkte në dispozicion për periudha më të vogla që mbulojnë muajin kalendarik. Në Proçeset mujore të ankandit, PTR-të janë hedhur në ankand me shumën bazë të MW në orë, përveç në rast të periudhës së mirëmbajtjes. Për ankandin mujor, llogaritja e rezultateve të ankandit është bërë në të njëjtën kohë për të gjithë çiftet marrës-dhënës. Rezultatet mujore të ankandit janë llogaritur dymbëdhjetë (12) herë në vit.
- c. Proçesi Ditor i Ankandit, me Produktet në dispozicion gjatë 24 orëve të ditës kalendarike (23 ose 25 orë kur ora ditore ndryshon). Në Proçesin ditor të ankandit, PTR-të hidhen në ankand me sasi të ndryshme të MW në orë. Për ankandin ditor, llogaritja e rezultateve të ankandit është bërë në të njëjtën kohë për të gjithë çiftet marrës-dhënës. Rezultatet e përditshme të ankandit llogariten treqind e gjashtëdhjetë e pesë herë në vit. (ose, në rast të një viti të brishtë, tre qind e gjashtë dhjetë e gjashtë) herë në vit.

Neni 2.2 Kapaciteti i ofruar

1. Kapacitetet e ofruara për harqe të ndryshme kohore janë ofruar në ankande nga SEE CAO, në përputhje me marrëveshjen bilaterale ndërmjet OST-ve për respektimin e plotë të kushteve operative dhe standarteve të sigurisë të rrjetit të sistemeve të transmetimit
2. Të gjitha Kapacitetet ndërkufitare në dispozicion do të bëhen subjekt i Proçesit të ankandëve vjetore, mujore dhe ditore.
3. Pjesëmarrësit e Ankandit janë informuar në faqen e internetit të SEE CAO dhe në Platformën e Ankandit për kapacitetet e ofruara për çdo Proçes Ankandi.

Neni 2.3 Qëndrueshmëria / Reduktimi i PTR-ve të alokuara

1. Në Proçeset vjetore dhe mujore të ankandit, PTR-të hidhen në ankand në një bazë të fortë me përjashtim të Rrjetit të Sigurisë ose Forcës Madhore, ku në secilin rast PTR-të e alokuara mund të reduktohen.
2. PTR-të vjetore dhe mujore mund të reduktohen një orë para mbylljes së portës (gate closure) të nominimit afatgjatë. Pas kësaj kohe ato konsiderohen si të firmosura me përjashtim të rasteve të Forcës Madhore.
3. Reduktimi mund të fillohet nga OST-të pjesëmarrëse të interesuara, duke informuar SEE CAO-n për kushtet e rrjetit dhe duke konfirmuar uljen e kapacitetit të transmetimit. Reduktimi shpallet nga SEE CAO në bazë të vendimit të Pjesëmarrësve të OST-ve. SEE CAO informon menjëherë të gjithë Pjesëmarrësit e ankandit me një mesazh në Platformën e ankandit për datën, kohëzgjatjen dhe shtrirjen e reduktimit.
4. Lajmërimi për reduktimin e PTR-ve të alokuara, të hedhura në ankand në Proçeset vjetore dhe mujore të ankandit me një shpjegim përkatës do të publikohen në faqen e internetit të SEE CAO.
5. Në rast se situata në rrjetin e transmetimit është përmirësuar para publikimit të Specifikimit të Ankandit për Proçesin e ankandit ditor, PTR-të përkatëse të lëshuara si rezultat i shkurtimit të mëparshëm, do të ofrohen në Proçesin ditor të ankandit.
6. Shkurtimi i PTR-ve të alokuara të hedhura në ankand në Proçeset vjetore dhe mujore të ankandit është i bazuar në parimet e proporcionalitetit. Raporti i shkurtimit për çiftin marrës-dhënës është llogaritur në këtë mënyrë:

$$CR_{xy} = \frac{RC_{xy}}{TAP_{xy}}$$

Ku: x Burimi i zonës së kontrollit
y Zona e kontrollit dhënës
CR Raporti i shkurtimit i një çifti marrës-dhënës
RC Reduktimi i vlerës NTC i deklaruar nga pjesëmarrësit e interesuar të
OST
TAP PTR-të totale të alokuar i një çifti marrës-dhënës

7. Vlera e shkurtuar e çdo PTR-je të alokuar pas reduktimit është përftuar duke shumëzuar PTR-në përkatëse të alokuar me raportin e reduktimit.

$$\text{Reduktimi i } PTR_{xy} = CR_{xy} \cdot PTR_{xy}$$

Shëmbull: $RC=100\text{MW}$
 $TAP=400\text{ MW}$
 $PTR=60\text{ MW}$
 $CR = 100/400=0.25$
 $\text{Reduktimi i } PTR=0.25 \times 60= 15\text{MW.}$

8. Çdo PTR e alokuar e hedhur në ankand vjetor dhe mujor pas reduktimit proporcional do të rrumbullakoset deri në vlerën më të afërt MW. Vlera e re e PTR-së pas reduktimit llogaritet në këtë mënyrë:

$$\text{Vlera e re } PTR_{xy} = (1 - CR_{xy}) \cdot PTR_{xy}$$

9. SEE CAO informon çdo Pjesëmarrës Ankandi për PTR-në e reduktuar me mesazh elektronik nëpërmjet Platformës së Ankandit dhe me e-mail.
10. Në rastin e reduktimit (Forca Madhore ose Siguria e Rrjetit), çdo Pjesëmarrës në Ankand, PTR-ja e të cilit është reduktuar, ka të drejtën e rimbursimit nga SEE CAO në përputhje me nenin 15.1. Çdo Pjesëmarrës Ankandi do të informohet nga SEE CAO për sasinë e një rimbursimi të tillë.

Neni 2.4 Qëndrueshmëria e shkëmbimeve të programit

1. Qëndrueshmëria dhe reduktimi i Shkëmbimeve të Programit është përgjegjësi e çdo OST-je pjesëmarrëse.

2. Pjesëmarrësit e OST-ve garantojnë realizimin e shkëmbimeve të Programit në përputhje me PTR-në e alokuar me përjashtim të rrethanave që përbëjnë Forcën Madhore.
3. Për rrethanat që përbëjnë Forcën Madhore SEE CAO është i detyruar që të kompensojë vetëm PTR-në e reduktuar për mbajtësit e PTR-ve me 100% të Çmimit të Ankandit. Pas rimbursimit të PTR-së së alokuar, të reduktuar, nuk do të lindin më detyrime të tjera.
4. Përgjegjësia e SEE CAO nuk do të cënohet nga dëmet e shkaktuara në Pjesëmarrësit e Ankandit për shkak të reduktimeve të Shkëmbimeve të Programit siç përshkruhet këtu.

Neni 2.5 Tregu sekondar

1. Tregu Sekondar mundëson si në vijim:
 - a. Transferimin e PTR-ve të alokuara vjetore dhe/ose mujore midis pjesëmarrësve të ankandit në përputhje me nenin 8.
 - b. Rishitja e PTR-ve të alokuara në Proçesin e Ankandit vjetor për Proçesin e Ankandit mujor, në pajtim me nenin 9, dhe PTR-te e alokuara vjetore dhe mujore të pa-nominuara alokuar për proçesin Ankandit ditor (UIOSI) në pajtim me nenin 10.3.
2. Pjesëmarrësi i Ankandit që mban PTR-në e alokuar duhet të përmbushë detyrimet financiare ndaj SEE CAO në lidhje me PTR-të e alokuara, pavarësisht nëse një pjesë, ose të gjitha PTR-të e alokuara do të transferohen ose do të rishiten.

Neni 2.6 Publikimi në Website

1. SEE CAO do të publikojë në vijim në faqen e saj dhe/ose në Platformën e Ankandit:
 - a. Rregullat e ankandit, dhe të gjitha ndryshimet e tyre;
 - b. Njoftimet në pajtim me këto Rregulla ankandi;

- c. Kalendarin e proçeseve vjetore dhe mujore të ankandit;
- d. Afatin e fundit për nominimin e PTR-ve vjetore dhe mujore të akorduara me pjesëmarrësit e Ankandit në Proçesin e skedulimit të OST- pjesëmarrëse.
- e. Specifikimet e ankandit;
- f. Emrat, fax-in dhe numrat e telefonit, adresat e e-mail të personelit të SEE CAO;
- g. Dokumentet standarte që lidhen me proçesin e ankandit për tu shkarkuar dhe
përdorur nga Pjesëmarrësit e Ankandit;
- h. Rezultatet e proçesit të ankandit;
- Kapaciteti i Ofruar;
 - Kapaciteti i kërkuar (Sasia Totale e Ofertës)
 - PTR-të e lejuara
 - Numri dhe lista e pjesëmarrësve të ankandit me ofertat e suksesshme si dhe numrin e përgjithshëm të Pjesëmarrësve të Ankandit që kanë marrë pjesë në Proçesin e Ankandit;
 - Çmimi marxhinal;

- i. Të gjitha informacionet në lidhje me reduktimin;
- j. Njoftimet që lidhen me kthimin e ankandit në kushtet fillestare;
- k. Të gjitha informacionet e tjera relevante.

Neni 2.7 Sjellja e Pjesëmarrësit të Ankadit

1. Para, gjatë dhe pas një Proçesi Ankandi, Pjesëmarrësit e Ankandit duhet të përmbahen nga çdo veprim apo sjellje e cila ndikon negativisht apo kërcënon të ndikojë negativisht në Proçesin e Ankandit, ose që në ndonjë mënyrë tjetër prish ose kërcënon të prishi proçesin e ankandit, transparencën, efektivitetin e kostove apo drejtësinë e tij.
2. SEE CAO do të raportojë tek OST-të pjesëmarrëse në mënyrë që ata të mund të informojnë autoritetet kompetente kombëtare rregullatore dhe të marrë masat e duhura ndaj atyre Pjesëmarrësve të Ankandit që veprojnë, sillen, ose kanë vepruar në kundërshtim me paragrafin e mëparshëm, që keqpërdorin ndonjë të drejtë apo pozitë të përftuar, ose që nuk përputhen me ndonjë dispozitë të Rregullores së Ankandit.

Neni 2.8 Monedha

Të gjitha informacionet ekonomike janë të shprehura në Euro.

Neni 2.9 Koha

I gjithë koordinimi i kohës së Rregullores së Ankandit i referohen Kohës Qendrore Europiane (CET).

Paragrafi 3. Kërkesat për pjesëmarrjen

Neni 3.1.Proçedura e regjistrimit

1. Me qëllim që të marrin pjesë në Proçeset e Ankadeve vjetore, mujore dhe ditore dhe/ose në Tregun Sekondar, Pjesëmarrësit e Tregut duhet të jenë regjistruar në SEE CAO si Pjesëmarrës Tregu duke plotësuar me sukses Deklaratën e Pranimit e cila është publikuar në faqen e internetit të SEE CAO (shih Aneksin 4).

2. Pjesëmarrësit e Tregut duhet të kenë nënshkruar dhe të bien dakord mbi termat e të paktën njërit prej dokumenteve të përmendura në Aneksin 4, Shtojca 2. Kjo do të thotë se duhet të jenë pjesëmarrës të tregut të regjistruar në të paktën një prej vendeve pjesëmarrëse në SEE.
3. Me qëllim që të regjistrohen si Pjesëmarrës në Ankand, Pjesëmarrësit e tregut do të:
 - Dërgojnë Deklaratën e Pranimi (2 kopje të nënshkruara dhe të firmosura)
 - Përbushin kërkesat financiare në përputhje me Paragrafin 4.
4. Pasi SEE CAO ka marrë të gjithë informacionin e nevojshëm, dhe në rast të lëshimit të një konfirmimi duhet ti kthejë një kopje të Deklaratës së Pranimi të nënshkruar prej tij Pjesëmarrësit në Ankand pa vonesë. Nënshkrimi i Deklaratës së pranimi nga SEE CAO nuk tregon përputhshmërinë me ndonjë kusht tjetër të përcaktuar në këtë Rregullore për Pjesëmarrësit në Ankand. Deklarata e Pranimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga SEE CAO.
5. Pjesëmarrësi në Ankand do të sigurojë që të gjitha të dhënat dhe informacionet e tjera që ajo ofron për SEE CAO të jenë në pajtim me Rregulloren e Ankandit (duke përfshirë gjithashtu dhe informacionin në Kontratën e tij Kornizë), të dhëna dhe informacione që duhet të jenë dhe mbeten të sakta dhe të plota në të gjitha aspektet materiale dhe në rast të ndonjë ndryshimi duhet menjëherë të njoftojnë SEE CAO.
6. Pjesëmarrësi i Ankandit duhet të njoftojë SEE CAO-n nëse ka ndonjë ndryshim informacioni, sipas nenit 3 të Shtojces 4 të kësaj Rregulloreje Ankandit, së paku shtatë (7) ditë pune para se ndryshimi të hyjë në fuqi. Kur kjo nuk është e mundur, brenda kohës më të shkurtër të mundshme pasi Pjesëmarrësit në Ankand duhet të vihen në dijeni të ndryshimit. SEE CAO do të konfirmojë regjistrimin e ndryshimit, ose të dërgojë një shënim refuzimi të regjistrimit të ndryshimit Pjesëmarrësit në Ankand, jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas pranimi të njoftimit përkatës të ndryshimit. Konfirmimi ose refuzimi do të dërgohen nëpërmjet postës elektronike përfaqësuesit ligjor dhe personit operacional specifikuar nga Pjesëmarrësi në Ankand, në përputhje me Aneksin 4 të Rregullores së Ankandit. Nëse SEE CAO refuzon të regjistrojë ndryshimin, arsyeja duhet të jepet në shënimin e refuzimit.
7. Ndryshimi bëhet i vlefshëm në ditën e dorëzimit të konfirmimit të Pjesëmarrësit të Ankandit.
8. SEE CAO ka të drejtë të kërkojë me shkrim për një përditësim apo ridërgim të ndonjë pjese të dokumentacionit të regjistrimit (shih Nenin 3 të Deklaratës së Pranimi, Aneksi 4). Dështimi i Pjesëmarrësit të Ankandit për të rinovuar apo

ridërguar të gjithë, ose një pjesë të dokumentacionit të regjistrimit në përputhje me kërkesën e SEE CAO-s brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas dorëzimit të kërkesës, i jep të drejtë SEE CAO-s të ndërpresë kontratën kornizë.

9. Në qoftë se kërkohet informacion shtesë nga një Pjesëmarrës në Ankand, si pasojë e një amendamenti të kësaj Rregulloreje Ankandi, atëherë Pjesëmarrësi në Ankand duhet të dorëzojë informacion shtesë për SEE CAO brenda dhjetë (10) ditë pune pas kërkesës për dorëzim të tillë nga SEE CAO.
10. Vetëm Pjesëmarrësit në Ankand, të cilët me paraqitjen e Deklaratës së Pranimit, deklarojnë ligjërisht detyrues dhe kategorike dijen e tyre të plotë dhe të gjerë në pranimin e Rregullores të ankandit, të vlefshme dhe efektive, siç publikohen në faqen e internetit të SEE CAO (www.seecao.com) dhe zotohen se nuk do të angazhohen në asnjë veprim apo sjellje që mund të ndikojë në garën e Proçesit të Ankandit, ose që ka për qëllim që në ndonjë mënyrë të prishë apo kërcënojë Proçesin e Ankandit, transparencën, efektivitetin e kostos apo drejtësinë e Proçesit të Ankandit, mund të marrë pjesë në proçesin e Ankandit.
11. Përsa i përket faktit që Proçesi i Ankandit është egzekutuar në Platformën e Ankandit, pjesëmarrësit e interesuar për të marrë pjesë në Proçesin e Ankandit janë gjithashtu të detyruar të përmbushin kërkesat bazë për aksesim të Platformës së Tregut të cilat janë specifikuar në Nenin 6.2.
12. Me nënshkrimin e Deklaratës së Pranimit, Pjesëmarrësi i Ankandit garanton që:
 - Ai nuk ka filluar ndonjë procedurë e cila kërkon një gjykim të paaftësisë paguese falimentimit ose ndonjë lehtësim tjetër sipas ndonjë ligji falimentimi, paaftësie paguese ose sipas ndonjë ligji të ngjashëm që ndikon në të drejtat e kreditorëve.
 - Asnjë paaftësi paguese, falimentimi ose procedura të ngjashme ligjore që ndikojnë në të drejtat e kreditorëve nuk janë filluar në lidhje me aplikuesin.
 - Asnjë shpërbërje ose procedurë likuidimi nuk janë filluar në lidhje me aplikantin dhe,
 - Ai nuk ka detyrime paguese të prapambetura kundrejt SEE CAO.
13. Një Pjesëmarrës në Ankand duhet të informojë pa vonesë SEE CAO-n për të gjitha faktet që përbëjnë ose mund të çojnë në një situatë në të cilën ai nuk kualifikohet për pjesëmarrje në Proçesin e Ankandit, sipas procedurës së sipërpërmendur. Në rast se Pjesëmarrësi në Ankand nuk vepron në përputhje me informacionin e detyrimeve të tij të lartpërmendura, SEE CAO rezervon të drejtën

për të ndërprerë Kontratën Kornizë siç është përcaktuar në paragrafin 16 të Regullores së Ankandit.

14. Me nënshkrimin dhe dorëzimin e Deklaratës së Pranimi në SEE CAO, Pjesëmarrësi i Ankandit autorizon SEE CAO-n për të verifikuar deklaratat përkatëse të Pjesëmarrësve të Ankandit.

15. Pjesëmarrësi në Ankand bie dakord që emri i tij të përfshihet në Regjistrin e Pjesëmarrësve në Ankand, të publikuar në faqen e internetit të SEE CAO.

Paragrafi 4. Kërkesat Financiare dhe Manaxhimi i Rrezikut

Neni 4.1. Dispozita të Përgjithshme

1. Në mënyrë që të sigurojë një proces të sigurt Ankandi, për të shmangur keqpërdorimin e PTR-së dhe për të siguruar pagesat që rezultojnë nga proceset e ankandeve vjetore, mujore dhe ditore, SEE CAO është përgjegjës për të zbatuar instrumentet e menaxhimit të rrezikut që duhet të zbatohen.
2. Të vetmet instrumente të menaxhimit të rrezikut që janë pranuar në Proçesin e Ankandit janë: Depozita në llogarinë bankare të Bankës së SEE CAO dhe/ose Garancia Bankare. Në mënyrë që të sigurohen instrumente të tilla, të gjitha tarifat e bankës do të mbulohen nga Pjesëmarrësi i Ankandit.
3. Shuma e vlerës së instrumenteve të menaxhimit të rrezikut që ofron një Pjesëmarrës në Ankand përcakton Kufirin e Kreditit (Besueshmërisë) të Pjesëmarrësit në Ankand (për detaje shih nenin 4.4). Ofertat e Pjesëmarrësve në Ankand do të konsiderohen në Proçesin e Ankandit vetëm nëse kufiri i nevojshëm i Kreditit (Besueshmërisë) është i disponueshëm (për detaje shih Nenet 7.2, 7.3 dhe 7.4). Nenet 12 deri në 14 specifikojnë të gjitha rrethanat në të cilat SEE CAO ka të drejtë të ushtrojë instrumentet e menaxhimit të rrezikut.
4. Pjesëmarrësi në Ankand është përgjegjës për sigurimin e një sasive të mjaftueshme të Kufirit të Kreditit me qëllim që të parandalojë përjashtimin e ofertave të tij nga procesi i Ankandit, për shkak të kërkesave për manaxhimin e rrezikut, siç përcaktohet në Nenin 7.2, 7.3 dhe 7.4.
5. E vetmja monedhë e pranuar si instrument i manaxhimit të rrezikut është EUR.
6. Të gjitha shpenzimet që lindin në procesin e promovimit dhe Verifikimi i instrumenteve të manaxhimit të riskut do të mbulohet nga pjesëmarrësit në ankand.

Neni 4.2. Instrumentet e Pranuara të Manaxhimit të Rrezikut

1. Çdo pjesëmarrës në treg i cili dëshiron të njihet si Pjesëmarrës në Ankand, mund të sigurojë një nga instrumentet e mëposhtme të manaxhimit të rrezikut:
 - a. Një Depozitë që Pjesëmarrësi në Ankand depoziton në llogarinë bankare të SEE CAO.
 - Kontrata e Depozitës do të përfundohet midis SEE CAO-s dhe Pjesëmarrësve respektive me afate vlefshmërie të përcaktuara nga Pjesëmarrësi në Ankand, sikurse është specifikuar në Aneksin 7.

- Depozita do të manaxhohet, kontrollohet dhe operohet ekskluzivisht nga SEE CAO.
 - Çdo pagesë bankare apo interesa të lidhura me Depozitën duhet të pranohen apo kreditohen për nga Pjesëmarrësi në Ankand.
 - SEE CAO ka të drejtë të përdorë depozitën në lidhje me Kapacitetet e Alokua në rast të mospagesës.
 - Sasia e parave në Depozitë do të merret parasysh në lidhje me kufirin e Kreditit dhe do të bllokohen në përputhje me Nenin 4.5.
 - Pjesëmarrësi në Ankand ka të drejtë të tërheqë interesat për depozitën e kredituar në llogarinë bankare të SEE CAO, në shumën e përcaktuar me dekretin përkatës në lidhje me normat e interesit të lëshuara nga banka ku është vendosur depozita.
 - Kjo Depozitë mund të shërbejë vetëm si një instrument i menaxhimit të rrezikut dhe nuk do të përdoret si një pagesë paraprake.
- b. Garancia Bankare lëshuar nga një bankë me një normë afatgjatë të kreditit të “BBB -”(S&P) apo “Baa3” (Moody’s) apo “BBB-” (Fitch/IBCA) apo më lartë, duke siguruar detyrimin e pagesës së papaguar të Pjesëmarrësit në Ankand, që rezulton nga Proçesi i Ankandit (më poshtë “Garanci Bankare”).
- Garancia Bankare do të merret parasysh në Kufirin e Kreditit me sasinë maksimale të tërheqjes.
 - Detaje përsa i përket Garancisë Bankare dhe një shembull Garancie Bankare janë specifikuar në Shtojcën 6.
 - Një garanci bankare do të refuzohet dhe nuk pranohet për qëllimin e Limitit të Kreditit nga SEE CAO, nëse SEE CAO e vlerëson Garancinë Bankare të jetë e paplotë apo e papërputhur me parakushtet e përcaktuara me Aneksin 6 për qëllimin e Proçesit të Ankandit. SEE CAO menjëherë do të informojë Pjesëmarrësin në Ankand për refuzimin e kësaj garancie bankare nëpërmjet e-mail-it.
 - Garancia Bankare mund të shërbejë vetëm si një instrument i menaxhimit të rrezikut dhe jo si një instrument pagese të zakonshme.

Neni 4.3. Ndërrimi, Zgjerimi dhe Kthimi i Instrumenteve të Manaxhimit të Rrezikut

1. Garancitë ose Depozitat bankare mund të zëvendësohen ose të zgjerohen me një shtesë të garancisë apo Depozitës Bankare.
2. *Garancitë apo Depozitat bankare të cilat nuk janë shfrytëzuar dhe/ apo të cilat nuk ishin përdorur, do të kthehen, në bazë të kërkesës me shkrim të Pjesëmarrësit në Ankand, jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendarike pas pranimit të kërkesës. Në këtë situatë, Limiti i kreditit është ulur me sasinë e Garancisë Bankare apo Depozitave të cilat Pjesëmarrësi i Ankandit ka kërkuar që ti kthehen, një (1) ditë kalendarike pas pranimit të kërkesës.*
3. Depozitat të cilat nuk janë shfrytëzuar dhe / ose të cilat nuk janë ushtruar do të kthehen në bazë të kërkesës me shkrim të pjesëmarrësit e ankandit. Në këtë situatë, kufiri i kreditit zbritet nga sasia e Depozitave të cilën Pjesëmarrës në ankand ka kërkuar që të kthehen, një (1) ditë kalendarike pas marrjes së kërkesës. Kërkesa për kthimin e Depozitave do të përmbajë detajet e pagesës: Shuma e Depozitave për t'u kthyer, numrin e llogarisë së bankës, IBAN, emri dhe adresa e bankës dhe kodet BIC / SWIFT. Pas marrjes së kërkesës me shkrim, SEE CAO do të nënshkruajë ndërprerjen me konsensus të kontratës depozitave me pjesëmarrësin në ankand. Shuma e kërkuar do të përcillet në Pjesëmarrësit në Ankand jo më vonë se tre (3) Ditë Pune pas nënshkrimit me konsensus të Ndërprerjes të Kontratës së depozitave.

Neni 4.4. Llogaritja e Vlerës së Kufirit të Kreditit

1. SEE CAO do të llogarisë Kufirin e Kreditit si shumën e vlerës së të gjithë instrumenteve të manaxhimit të rrezikut, të siguruara nga Pjesëmarrësi në Ankand dhe të pranuar nga SEE CAO, duke përbërë kufirin maksimal të vlerës së PTR-së që mund ti jepet Pjesëmarrësit në Ankand në Proçesin e Ankandit.
2. Vlera e Kufirit të Kreditit është llogaritur për secilin Pjesëmarrës në Ankand si më poshtë:
 - a. Përpara Proçesit të Ankandit vjetor dhe mujor si shuma e mëposhtme:
 - Vlera maksimale e Garancive Bankare të bëra nga ana e Pjesëmarrësit në Ankand kundrejt SEE CAO-s, nëse ata përmbushin kërkesat në përputhje me nenin 4.2 (b). Pjesëmarrësi në Ankand është i detyruar të dërgojë Garancinë Bankare origjinale, të verifikuar nga nënshkrimi nëpërmjet SWIFT, ose i lëshuar nëpërmjet SWIFT për SEE CAO deri në 12:00 CET ditën e fundit të punës përpara ditës së Ankandit Vjetor (shih Kalendarin e Ankandeve) respektivisht rreth orës 12:00 CET ditën e fundit të punës

përpara Ankandit Mijor, me qëllim që të përfshihet Garancia Bankare në llogaritjen e Kufirit të Kreditit.

- Sasinë e depozitave të bëra nga ana e Pjesëmarrësit në Ankand kundrejt SEE CAO, nëse ata përmbushin kërkesat në përputhje me Nenin 4.2 (a). Pjesëmarrësi në Ankand është i detyruar të kreditojë një Depozitë në Llogarinë Bankare të Bankës së SEE CAO të paktën tre (3) ditë pune përpara ditës së Ankandit Vjetor, respektivisht ditën e Ankandit Mijor, me qëllim që Depozita të përfshihet në llogaritjen e Kufirit të Kreditit.

b. Përpara Proçesit të Ankandit ditor si një shumë e të mëposhtmeve:

- Vlerën maksimale të Garancive Bankare të kryera nga ana e Pjesëmarrësit në Ankand kundrejt SEE CAO, nëse ata përmbushin kërkesat në përputhje me Nenin 4.2 (b). Pjesëmarrësi në Ankand është i detyruar të dërgojë Garancinë Bankare në original pranë SEE CAO deri në 12:00 CET, ditën e fundit të Punës përpara ditës që ai jep porositë në Proçesin e Ankandit ditor, me qëllim që garancia Bankare të përfshihet në llogaritjen e Kufirit të Kreditit.
- Sasia e Depozitave të siguruara nga Pjesëmarrësi në Ankand për SEE CAO-n, nëse ata i plotësojnë kërkesat sipas nenit 4.2. (a). Pjesëmarrësi në Ankand është i detyruar të kreditojë një depozitë në llogarinë bankare të SEE CAO-s jo më vonë se tri (3) ditë pune para se ai të japë ofertat në Proçesin e Ankandit Ditor, me qëllim që depozita të përfshihet në llogaritjen e Kufirit të Kreditit.

Neni 4.5.Shfrytëzimi i Kufirit të Kreditit

1. SEE CAO do të shfrytëzojë Kufirin e Kreditit të Pjesëmarrësit në Ankand në përputhje me rregullat e mëposhtme:

- Për Proçesin e Ankandit Vjetor, Kufiri i Kreditit shfrytëzohet deri në sasinë e dy të dymbëdhjetave (2/12) të Vlerës së Ofertës Totale të Pjesëmarrësit në Ankand që rezulton nga proçesi i Ankandit Vjetor. Pas njoftimit të rezultateve të Proçesit të Ankandit të Pjesëmarrësi në Ankand, Kufiri i Kreditit shfrytëzohet deri në sasinë e dy të dymbëdhjetave (2/12) të detyrimit të përgjithshëm financiar të Pjesëmarrësit në Ankand, që rezulton nga PTR e rezervuar që i është dhënë këtij Pjesëmarrësi në Ankand në Proçesin e Ankandit vjetor respektiv. Pjesa e shfrytëzuar do të çlirohet pas vendosjes të së gjithë pagesës në përputhje me detyrimet {dymbëdhjetë (12) këste mujore} që rezultojnë nga proçesi i Ankandit Vjetor.

- Për procesin e Ankandit Mujor, limiti i kreditit është shfrytëzuar në sasinë e Vlerës Totale të Ofertës së Pjesëmarrësit në Ankand, që rezulton nga Proçesi i Ankandit Mujor. Pas njoftimit të rezultateve të Proçesit të ankandit, Limiti i Kreditit është shfrytëzuar në sasinë e detyrimeve totale të Pjesëmarrësit në Ankand që rezultojnë nga PTR e rezervuar, që i është ofruar këtij Pjesëmarrësi në Ankand në Proçesin e Ankandit mujor respektiv. Pjesa e shfrytëzuar do të çlirohet pasi të jenë shlyer detyrimet e pagesës që rezultojnë nga proçesi përkatës i Ankandit Mujor.
 - Për Proçesin e Ankandit ditor, Limiti i Kreditit është shfrytëzuar në sasinë e Vlerës Totale të Ofertës së Pjesëmarrësit në Ankand, që rezulton nga Proçesi i Ankandit Ditor. Në ditën e publikimit dhe njoftimit të rezultateve të bashkuara të Proçesit të Ankandit Ditor, SEE CAO do të shfrytëzojë Kufirin e Kreditit të Pjesëmarrësit në Ankand me një shumë të barabartë me detyrimin e tij të përgjithshëm financiar, që rezulton nga PTR-ja caktuar këtij pjesëmarrësi në ankand nga proçesi përkatës i Ankandit Ditor.
2. Për vlerësimin e Kufirit të Kreditit i cili nuk do të shfrytëzohet në Proçeset e Ankandit Vjetor dhe Mujor për Pjesëmarrësin individual në Ankand, kufiri i kreditit të shfrytëzuar që rezulton nga pjesëmarrja e tij në Proçesin e Ankandit llogaritet në orën 15:00 CET në ditën e publikimit të rezultatit final për proçesin e Ankandit Vjetor dhe atij Mujor. Në rastin e Proçesit të Ankandit ditor, vlerësimi i kufirit të kreditit kryhet në orën 08:30 CET në D-1.
 3. SEE CAO do të shfrytëzojë Kufirin e Kreditit deri në sasinë e detyrimeve të papaguara të Pjesëmarrësit në Ankand. Në rastin e kufizimit të PTR-së ditore, veçanërisht sasia e rimbursuar nuk do të merret kur shfrytëzohet Kufiri i Kreditit.
 4. Në rast se ka Kufi Krediti jo të mjaftueshëm, p.sh. për shkak të ndryshimit të vendit të regjistrimit të Pjesëmarrësit në Ankand për taksim gjatë vitit, Pjesëmarrësi në Ankand është i detyruar të rrisë Kufirin e Kreditit brenda 15 ditëve kalendarike që në momentin që Pjesëmarrësi në Ankand informohet për Kufirin e pamjaftueshëm të Kreditit nga SEE CAO me e-mail. Nëse Pjesëmarrësi në Ankand nuk e rrit Kufirin e Kreditit brenda afatit të përshkruar, Kontrata Kornizë do të përfundojë në përputhje me nenin 17.
 5. Nëse ofertat e Pjesëmarrësit në Ankand janë refuzuar në Platformën e Ankandit për shkak të Kufirit të pamjaftueshëm të Kreditit, dhe Pjesëmarrësi në Ankand mendon se Kufiri i Kreditit duhej të ishte i mjaftueshëm për të mbuluar ofertat e tij, Pjesëmarrësi në Ankand është i detyruar të informojë menjëherë SEE CAO-n para afatit të kontestimit për atë ankand.

Paragrafi 5. Proçesi i Ankandit

Neni 5.1. Dispozita të përgjithshme

1. Përpara çdo Proçes Ankandi, SEE CAO publikon informacion përsa i përket kapacitetit të ofruar në Specifikimet e Ankandit në faqen e internetit të SEE CAO-s sipas datave të përcaktuara në kalendarin e Ankandit.
2. Proçeset e Ankandit organizohen dhe ekzekutohen nga SEE CAO, elektronikisht përmes Platformës së Ankandit. Secili Pjesëmarrës në Ankand që plotëson kërkesat për pjesëmarrje në Proçesin e Ankandit mund të dërgojë Oferta në Platformën e Ankandit derisa të përfundojë afati përkatës për dërgimin e Ofertave në Proçesin e Ankandit specifik.
3. Për Proçeset e Ankandit vjetor dhe mujor vetëm PTR-të e rezervuara do tu alokohen Pjesëmarrësve në Ankand. Këto do të bëhen PTR të alokuara atëherë kur pagesat e kërkuara do të kryhen në përputhje me këtë Rregullore Ankandi. Në proçeset e Ankandeve Ditore, PTR-të do tu alokohen drejtpërsëdrejti Pjesëmarrësve në Ankand dhe do të bëhen PTR të alokuara menjëherë pas njoftimit të rezultateve të Proçesit të Ankandit kundrejt këtyre të fundit.
4. SEE CAO do të kontrollojë Kufirin e Kreditit të Pjesëmarrësit në Ankand, gjatë Proçesit të Ankandit, me qëllim që të sigurohet pagesa e Pjesëmarrësit në Ankand. Nëse Kufiri i kreditit nuk është i mjaftueshëm, PTR-të do tu jepen një tjetër Pjesëmarrësi në Ankand, sipas nenit 7.1. Rezultatet e proçesit të ankandit do tu njoftohen Pjesëmarrësve të cilëve u është akorduar PTR në Ankand.

Neni 5.2. Specifikimet e Ankandit

1. Specifikimet e Ankandit konsistojnë në informacionin e mëposhtëm:
 - Tipi i produktit në dispozicion për Proçesin e Ankandit:
 - Produkti Vjetor: produktet bazë për gjithë vitin apo për periudha më të vogla që mbulojnë periudhën e mirëmbajtjes;
 - Produkti Mujor: produktet bazë për gjithë muajin apo për periudha më të vogla që mbulojnë periudhën e mirëmbajtjes;
 - Produkti Ditor: për çdo ore;
 - Kombinimet marrës-dhënës;
 - Kapaciteti i Ofruar;
 - Hapja e Portave dhe Mbyllja e Portave

- Afati kohor për publikimin e rezultateve të Proçesit të Ankandit;
- Afati për të kundërshtuar rezultatet e Proçesit të Ankandit në përputhje me Nenin 7.6
- Informacione të tjera plotësuese.

Neni 5.3.Proçesi i Ankandit Vjetor

1. SEE CAO publikon në faqen e vet të internetit, si informacion, një Kalendar të Ankandit i cili përmban datën e ankandit vjetor për vitin e ardhshëm kalendarik.
2. SEE CAO do të publikojë në faqen e vet të internetit, për çdo palë marrësdhënës, Specifikimet e Ankandit, së paku shtatë (7) ditë para ditës së Proçesit të ankandit vjetor. Gjithë informacioni i detajuar lidhur me proçesin e ankandit vjetor, publikohet në Specifikimet e Ankandit, në përputhje me nenin 5.2.
3. Pjesëmarrësit në Ankand duhet të dorëzojnë ofertat e tyre në periudhën kohore midis Hapjes së Portës dhe Mbylljes së Portës siç përcaktohet nga specifikimet e ankandit për proçesin përkatës të ankandit. Pjesëmarrësit në Ankand janë të lejuar të paraqesin ofertat e tyre me Indikacionin: "Të gjitha ose asgjë".
4. Ofertat duhet të dorëzohen në përputhje me nenin 5.6 ose, kur është e zbatueshme, me nenin 5.9.
5. Çdo Pjesëmarrës Ankandi informohet për rezultatin e ofertave të tij, në përputhje me nenin 7.5, jo më vonë se tridhjetë (30) minuta pas mbylljes së Portës të Proçesit të Ankandit vjetor. Rezultatet e Proçesit të Ankandit vjetor, publikohen në faqen e internetit të SEE CAO-s, pas mbylljes së Portës të Proçesit të Ankandit vjetor dhe jo më vonë se afati i parashikuar në kalendarin e ankandit.
6. Në rrethana të jashtëzakonshme, SEE CAO mund të shpallë në websitin e vet datat e Proçesit të Ankandit dhe Specifikimet e Ankandit të cilat devijojnë nga datat e treguara në kalendarin e ankandit. Arsyetimi për një modifikim të tillë, do të publikohet në faqen e internetit të SEE CAO-s.

Neni 5.4.Proçesi i Ankandit Mujor

1. SEE CAO publikon në faqen e vet të internetit, si informacion, një Kalendar Ankandi duke përcaktuar datat e Proçeseve të Ankandeve Mujore për vitin e ardhshëm kalendarik.
2. SEE CAO do të publikojë në faqen e vet të internetit, për çdo palë marrësdhënës, Specifikimet paraprake të Ankandit të paktën pesë (5) ditë para ditës së Proçesit të Ankandit Mujor, dhe do të konfirmojë Specifikimet e Ankandit si përfundimtare, të paktën dy (2) ditë para ditës së Proçesit të Ankandit Mujor. Gjithë informacioni i

detajuar për Proçesin e Ankandit Mujor është i publikuar në Specifikimet e Ankandit në përputhje me Nenin 5.2.

3. Proçesi i Ankandit Mujor zhvillohet, në një ditë pune, në muajin para muajit për të cilin PTR-të janë hedhur në ankand për tu shitur në Proçesin e Ankandit, në datat dhe orën e përcaktuar në Specifikimet e Ankandeve.
4. Kapaciteti i Ofruar për Proçesin e Ankandit mujor konsiston në:
 - Kapacitetin e Disponueshëm të Transmetimit të deklaruar për proçesin e Ankandit mujor,
 - Kapaciteti i mbuluar nga PTR e Alokuar gjatë Proçesit të Ankandit Vjetor, të cilat janë deklaruar për rishitje nga Pjesëmarrësit në Ankand.
 - Kapaciteti vjetor i alokuar tashmë nga SEE CAO i cili duhet të hiqet nga mbajtesi i PTR-së.
5. Pjesëmarrësit në Ankand do të dërgojnë ofertat e tyre në periudhën ndërmjet Hapjes së Portës dhe Mbylljes së Portës siç përcaktohet nga Specifikimet e Ankandit për Proçesin përkatës të Ankandit. Pjesëmarrësit në Ankand lejohen të dërgojnë ofertat e tyre me indikacionin “Të gjitha ose asgjë”.
6. Ofertat duhet të dërgohen në përputhje me Nenin 5.6 apo aty ku është e zbatueshme me Nenin 5.9.
7. Çdo Pjesëmarrës në Ankand informohet për rezultatin e ofertave të tij, në përputhje me nenin 7.5, jo më vonë se tridhjetë (30) minuta pas mbylljes së Portave të Proçesit të Ankandit mujor. Rezultatet nga Proçesi i Ankandit Mujor janë të publikuara në faqen e internetit të SEE CAO pas mbylljes së Portës së Proçesit të Ankandit mujor dhe jo më vonë se afati i parashikuar në kalendarin e ankandit.
8. Në rrethana të jashtëzakonshme, SEE CAO mund të shpallë në faqen e vetë të internetit datat e Proçesit të Ankandit dhe Specifikimet e Ankandit, të cilat devijojnë nga datat e treguara në Kalendarin e Ankandit. Arsyetimi për modifikime të tilla do të publikohen në faqen e internetit të SEE CAO.

Neni 5.5. Ankandet Ditore

1. SEE CAO do të publikojë në faqen e vetë të internetit dhe në Platformën e Ankandit, Specifikimet e Ankandit, në përputhje me Nenin 5.2 rreth orës 09:00 CET në ditën D-1.
2. Proçesi i Ankandit Ditor do të mbahet në çdo ditë kalendarike të ditës D-1.

3. Koha e hapjes së portës është 9:00 CET në ditën D-1.
4. Koha e mbylljes së portës është 9:30 CET në ditën D-1.
5. Pjesëmarrësi në Ankand do të dërgojë ofertat e tij në Platformën e Ankandit ndërmjet momenteve të Hapjes së Portës dhe Mbylljes së Portës. Pjesëmarrësit në Ankand janë të lejuar të dërgojnë Ofertat e tyre me Indikacionin: Të gjitha ose Asgjë”.
6. Të gjithë Pjesëmarrësit në Ankand informohen për rezultatet e Ofertës së tyre, në përputhje me nenin 7.5, jo më vonë se tridhjetë (30) minuta pas mbylljes së Portës të Proçesit të Ankandit Ditor (10:00 CET). Informacioni që rezulton nga Proçesi i Ankandit Ditor publikohet në faqen e internetit të SEE CAO jo më vonë se tridhjetë (30) minuta pas mbylljes së Portës së Proçesit të Ankandit Ditor.
7. Në situata të jashtzakonshme, SEE CAO mund të modifikojë Hapjen e Portës dhe Mbylljen e Portës për të gjithë apo për disa nga palët: marrës-dhënës. Justifikimi për këtë modifikim do të publikohet në faqen e internetit të SEE CAO.

Neni 5.6.Dorëzimi i Ofertës

1. Çdo ofertë e dërguar në një Proçes Ankandi duhet të përmbajë elementet e mëposhtëm:
 - Identifikimin e Pjesëmarrësit në Ankand në përputhje me Deklaratën e Pranimit;
 - Identifikimin e palëve: marrës-dhënës në përputhje me Specifikimet e Ankandit;
 - Vitin, muajin apo ditën të cilëve u referohet oferta;
 - Specifikimet e produktit (blok p.sh. baza e produkteve orare p.sh. H01)
 - Sasia e Ofertës i shprehur në MW pa presje dhjetore. Sasia minimale e ofertës është 1 MW;
 - Çmimi i Ofertës është i shprehur në €/MWh me dy (2) presje dhjetore. Çmimi minimal i ofertës duhet të jetë më i madh se 0.
 - Gjithë informacioni i duhur referuar formatit të ofertës është përcaktuar në dokumentacionin në dispozicion të faqes së internetit të SEE CAO.
2. Platforma e Ankandit nuk pranon oferta që:
 - Nuk përputhen me kërkesat e Nenit 5.6, Paragrafi 1

- nuk përmbushin algoritmin e manaxhimit të rrezikut në përputhje me Paragrafin 7.
 - Janë vendosur nga një Pjesëmarrës Ankandi i cili është pezulluar në përputhje me Paragrafin 16.
3. Me kusht që një ofertë ose një bashkësi ofertash të përmbushin kërkesat e përcaktuara në Nenin 5.6 Paragrafi 1 dhe Paragrafi 2, Platforma Ankandit duhet të konfirmojë tek Pjesëmarrësit e Ankandit që një ofertë e tillë ose disa oferta të tilla janë pranuar në mënyrë korrekte nga një konfirmim i faturës nëpërmjet Platformës së Ankandit dhe të përcaktojë vulën e kohës për këtë ofertë. Nëse Platforma Ankandit nuk lëshon një vërtetim të faturës për një ofertë ose lëshon një mesazh refuzimi atëherë oferta të tilla duhet të konsiderohen të pa pranuar.
 4. Platforma Ankandit duhet të njoftojë një Pjesëmarrës të Ankandit, oferta e të cilit është refuzuar si e pavlefshme, gjithashtu duhet ta njoftojë edhe për arsyen e refuzimit, pa një vonesë të tepruar pasi oferta është refuzuar.
 5. Platforma Ankandit duhet të mbajë një regjistër të gjithë ofertave të vlefshme të pranuar.
 6. Çdo ofertë e vlefshme e regjistruar gjatë Mbylljes së Portës duhet të përbëjë një ofertë të pakushtëzuar dhe të pakthyeshme nga Pjesëmarrësi i Ankandit për të rezervuar PTR-në deri në sasinë e ofertës dhe me çmime deri në çmimin e ofertës dhe sipas termave dhe kushteve të kësaj Rregullore të Ankandit dhe Specifikimeve të Ankandit përkatës.
 7. Pjesëmarrësi i Ankandit ka mundësinë që të vendosi oferta të paracaktuara për ankandet.

- Një ofertë e paracaktuar, fillimisht e identifikuar si e tillë nga Pjesëmarrësi i Ankandit, do aplikohet automatikisht tek çdo ankand pasues përkatës siç është përcaktuar nga Pjesëmarrësi i Ankandit kur vendos ofertën e paracaktuar. Me hapjen e portës, oferta e paracaktuar e regjistruar duhet të konsiderohet si një ofertë e dorëzuar nga pjesëmarrësi i ankandit për ankandin përkatës.
- Një Pjesëmarrës Ankandi i cili do të modifikojë ofertën e paracaktuar për ankandin aktual duhet të ndryshojë sasinë e ofertës dhe çmimin e ofertës të tij të paracaktuar para mbylljes së portës.
- Një Pjesëmarrës Ankandi i cili do të modifikojë një ofertë të paracaktuar për një ankand të ardhshëm duhet të ndryshojë sasinë e ofertës dhe çmimin e ofertës për ofertën e tij të paracaktuar para hapjes së portës.
- Një Pjesëmarrës Ankandi i cili nuk dëshiron të paraqesi ofertën e paracaktuar në Platformën e Ankandit për ankande të ardhshme mund ti anullojë ofertat e tij të paracaktuara përpara hapjes së portës pasuese.
- Vula e kohës së ofertës së paracaktuar korrespondon me kohën e krijimit ose përditësimit të ofertës së paracaktuar në sistem.

Neni 5.7. Kufizimet

1. Pjesëmarrësi në Ankand mund të dergojë një maksimum prej njëzetë (20) Ofertash për një Produkt.
2. Nëse sasia e ofertës, ose sasia e llogaritur si shumë e sasisë së disa ofertave të vendosura për të njëjtën Ankand, nga një Pjesëmarrës Ankandi tejkalon kapacitetin e ofruar të shpallur në Specifikimet përfundimtare të Ankandit, ajo ofertë, ose ato grup ofertash do të refuzohen tërësisht. Kur një modifikim i një oferte të mëparshme tejkalon Kapacitetin e Ofruar, oferta e modifikuar do të refuzohet dhe do të qëndrojë oferta e mëparshme.
3. Nëse sasia e një oferte, ose sasia e llogaritur si shumë e sasisë së disa ofertave për disa oferta të paracaktuara, vendosur për të njëjtin ankand, nga një Pjesëmarrës Ankandi tejkalon kapacitetin e ofruar, të shpallur në Specifikimet përfundimtare të Ankandit, oferta e paracaktuar me çmimin më të ulët të ofertës do të refuzohet derisa kapaciteti i kërkuar i ofertës të paracaktuar të jetë më i vogël ose i barabartë me kapacitetin e ofruar. Në rastin që ka oferta të paracaktuara me të njëjtin çmim do të refuzohet më parë ai me sasi më të ulët të ofertës.

Neni 5.8. Anullimi i Ankandit

1. Në rastin e pamundësisë apo vështirësive teknike me Platformën e Ankandit, SEE CAO mund të jetë e detyruar të anullojë Proçesin e Ankandit:

- a. Përpara dhe gjatë Proçesit të Ankandit: Pjesëmarrësit në Ankand janë të informuar me mesazh që shfaqet direkt në Platformën e Ankandit dhe, në faqen e internetit të SEE CAO dhe/ose me e-mail;
 - b. Në rastin e rezultateve të gabuara, pasi rezultatet paraprake të Proçesit të Ankandit të jenë dërguar, Pjesëmarrësit në Ankand informohen në Platformën e tyre të Ankandit dhe në faqen e internetit të SEE CAO dhe/ose me e-mail. Rezultatet e Proçesit të Ankandit janë anuluar për këtë arsye.
2. SEE CAO njofton Pjesëmarrësit në Ankand dhe publikon arsyet të cilat shkaktuan anulimin e Proçesit të Ankandit në faqen e vetë të internetit sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 5.9. Kthimi në kushtet fillestare të Ankandeve Vjetore dhe Mujore

1. Në rastin kur SEE CAO e ka të pamundur të mbajë Ankande Vjetore apo Ankande Mujore në kushte standarte, SEE CAO mund të organizojë një kthim në kushtet fillestare. Në këtë situatë, SEE CAO i dërgon njoftime Pjesëmarrësit në ankand, nëpërmjet një e-maili dhe nëpërmjet Platformës së Ankandit dhe/ose në faqen e internetit të SEE CAO apo nëpërmjet faksit, në lidhje me vendimin për kthimin në kushtet fillestare për Proçesin e Ankandit. Kthimi në kushtet fillestare është:
 - Shtyrja e një Ankandi në një datë më të vonë. Njoftimi specifikon, minimalisht, datën e re të skedulimit të Ankandit;
2. Njoftimi i kthimit në kushtet fillestare për Ankandet tregon gjithë detajet për procedurat e shtyrjes të Ankandeve Vjetore e Mujore. SEE CAO nuk mund të jetë përgjegjës në asnjë rrethanë, nëse është i paafte të kontaktojë Pjesëmarrësit në Ankand nëpërmjet kanaleve të përmendura më sipër, apo nëse është i paafte të publikojë lajmërimin në faqen e vetë të internetit të SEE CAO. Ofertat e dërguara më përpara kthimit në kushtet fillestare për proçeset e Ankandeve, konsiderohen të pavlefshme dhe duhet të dërgohen përsëri, në përputhje me kushtet e parapërcaktuara, në rastin e kthimit në kushtet fillestare të Proçesit të Ankandeve.
3. Nëse kushtet e parapërcaktuara në rastin e kthimit në kushtet fillestare për proçeset e Ankandeve nuk mund të zbatohen në kohë për një Proçes të dhënë Ankandi, ky Proçes Ankandi shtyhet përsëri apo anulohet dhe Ofertat që janë dërguar tashmë, anulohen automatikisht.

Neni 5.10. Kthimi në kushtet fillestare i Ankandeve Ditore

1. Nëse SEE CAO, pas publikimit të Specifikimeve të Ankandit, e ka të pamundur të mbajë një Proçes Ankandit Ditor nën kushtet standarte të parapërcaktuara në Nenet 5.5, SEE CAO do të dërgojë Njoftim Pjesëmarrësit në ankand për vendimin e kthimit në kushtet fillestare për Proçesin e Ankandit ditore.
2. Në këtë rast, dhe nëse është e aplikueshme, do të aplikohet një Alokim me pjesë proporcionale. Kapaciteti i ofruar në palët Marrës-dhënëse ndahet në pjesë të barabarta ndërmjet Pjesëmarrësve të lejuar në Ankand, në palët e angazhuara marrës-dhënëse.
3. Çmimi i PTR është 0 €/MWh. Vlera e PTR do të rrumbullakoset deri në vlerën më të afërt në MW.
4. Me mënyrën e kthimit në kushtet fillestare të Ankandit ditore, vetëm ofertat e paracaktuara do të konsiderohen. Pjesëmarrësit në Ankand janë të lejuar të dërgojnë oferta të paracaktuara përmes Platformës së Ankandit në përputhje me Nenin 5.6.
5. Ofertat e paracaktuara të dërguara në D-2 14:00 CET do të merren në konsideratë në Proçesin e Ankandit Ditor. Nëse sasia e ofertës është më e lartë se kapaciteti i ofruar, sasia e ofertës do të zvogëlohet deri në vlerën e kapaciteteve të ofruara.
6. Pjesëmarrësit në Ankand do të informohen rreth rezultateve nga ora 10:15 CET, në D-1.

Paragrafi 6: Platforma e Ankandit

Neni 6.1. Dispozita të Përgjithshme

1. SEE CAO do të organizojë dhe egzekutojë Proçese të koordinuara të Ankandit për PTR-të vjetore, mujore e ditore, elektronikisht në mjedisin e përdoruesit të platformës së Ankandit.
2. Platforma e Ankandit është krijuar për të vetmin qëllim të egzekutimit të Proçeseve të Ankandit si një aplikacion web-i.
3. SEE CAO do të sigurojë Pjesëmarrësve në Ankand intruksionet operationale në lidhje me përdorimin e platformës.

4. SEE CAO do të sigurojë një sportel suporti për të gjithë Pjesëmarrësit në Ankand. Informacioni i kontaktit dhe orët e operimit të sportelit të suportit, do të publikohen në faqen e internetit të SEE CAO-s.
5. SEE CAO rezervon të drejtën të ndryshojë një rregjim ditor biznesi nga ana operacionale, si psh kohët e mbylljes në rastet e daljes së problemeve teknike, veçanërisht të mëposhtmet:
 - Një kolaps i përgjithshëm i internetit,
 - Një kolaps i të gjitha lidhjeve të internetit të Platformës së Ankandit;
 - Një kolaps i Platformës së Ankandit (serverave, databazave apo gabim në aplikacionin e Platformës së Ankandit) apo një problem i ngjashëm në shkëmbimin e të dhënave ndërmjet SEE CAO dhe OST-ve Pjesëmarrëse. Të gjithë Pjesëmarrësit e Ankandit do të informohen nëpërmjet njoftimit të publikuar në Platformën e Ankandit apo në faqen e internetit të SEE CAO-s apo me e-mail, pa vonesa të panevojëshme, të situatave operacionale aktuale.
6. Të gjitha të dhënat kohore të përcaktuara në Rregulloren e Ankandit – veçanërisht afatet për transferimin e të dhënave, lajmërimet e rezultateve, etj. – janë në përputhje me Kohën e Sistemit të Platformës së Ankandit (CET). Mjedisi i Përdoruesit punon gjithashtu me Kohën e Sistemit të Platformës së Ankandit.
7. Pjesëmarrësit në Ankand janë të ndaluar të postojnë apo transmetojnë në apo prej Platformës së Ankandit dhe apo prej Bordit të Njoftimeve çdo material që është i paligjshëm apo teknikisht i dëmshëm.

Neni 6.2. Aksesimi në Platformën e Ankandit

1. Platforma e Ankandit është në dispozicion të të gjithë Pjesëmarrësve në Ankand që kanë një web browser (Internet Explorer 7.0 ose më të lartë, Mozilla Firefox 3.0 ose më të lartë) certifikata elektronike (tokën), dhe një llogari përdoruesi të dhënë prej SEE CAO-s.
2. Secili përdorues kërkohet të përdorë certifikata elektronike për qëllimet e aksesimit të Platformës së Ankandit dhe ekzekutimit të transaksioneve të biznesit nëpërmjet Platformës së Ankandit. Të gjitha informacionet në lidhje me marrjen e certifikatës elektronike janë të publikuara në websitin e SEE CAO-s (www.seecacao.com).
3. Pasi Pjesëmarrësi në Ankand regjistrohet nga SEE CAO, llogaritë e përdoruesit do të futen në Platformën e Ankandit. Pjesëmarrësi në Ankand do të dërgojë Formë Aplikimi të plotësuar (shih Aneksin 5) për në SEE CAO për të krijuar dhe modifikuar llogaritë për gjithë përdoruesit e vet. Forma e aplikimit duhet të nënshkruhet gjithashtu nga përdoruesi që pranon detyrimet dhe rregullat e sjelljes të përcaktuara në këtë Rregullore të Ankandit. Të gjitha paragrafët e formës së

aplikimit duhet të përmbajnë informacion të plotë e të vërtetë. SEE CAO do të krijojë një llogari përdoruesi ose do të modifikojë një llogari përdoruesi brenda tre (3) Ditëve pune pas tërheqjes së Formës së Aplikimit.

4. Çdo përdorues i ri apo një përdorues i vjetër, me një llogari të modifikuar përdoruesi, informohet rreth krijimit apo modifikimit të llogarisë së përdoruesit, nëpërmjet e-mailit, në adresën e kontaktit të dhënë e formën e aplikimit. Informacioni i e-mail-it dërguar nga SEE CAO do të përfshijë një çelës hyrjeje që konsiston në një emër përdoruesi (login) dhe një fjalëkalim të ri në rastin e një llogarie të re përdoruesi. Përdoruesi është i detyruar ta ndryshojë fjalëkalimin gjatë logimit të parë. Përdoruesi do ta mbajë këtë informacion si konfidencial. Pjesëmarrësi në Ankand do të jetë përgjegjës për çdo dëmtim direkt apo jodirekt që rezulton nga ndonjë zbulim i fajshëm dhe i paautorizuar i një informacioni të tillë nga përdoruesi. SEE CAO nuk është përgjegjës për asnjë përdorim të paautorizuar të çelësit hyrës që përmban emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin.
5. SEE CAO-s do ti jepet e drejta të verifikojë informacionin e deklaruar në formën e aplikimit, të dërguar nga përdoruesit e mundshëm dhe jo të krijojë llogari përdoruesi në rast të ndonjë mospërputhjeje në të dhënat e ofruara, ose në ndonjë rast dyshimi në lidhje me këtë çështje. SEE CAO do ti jepet e drejta të pengojë Përdoruesin të aksesojë Platformën e Ankandit në rast se gjen ndonjë mospërputhje, por pa u kufizuar në të mëposhtmet: Informacion i gabuar rreth përdoruesit apo çertifikatës, skadimit të çertifikatës së Përdoruesit, ose skadimi i Kontratës Kornizë ndërmjet SEE CAO-s dhe Pjesëmarrësit në Ankand të përfaqësuar nga ky Përdorues.
6. Përdoruesi i Platformës së Ankandit do ti ekzekutojë transaksione biznesi dhe konfigurime të llogarisë së tij përdoruesit në mjedisin e këtij të fundit. Mjedisi i përdoruesit ofron në veçanti:
 - Informacion mbi Kohën e Sistemit të Platformës së Ankandit.
 - Mesazhe nga SEE CAO (p. sh. Konfirmimin e operacioneve të ekzekutuara).
 - Grupi i komandave për ekzekutimin e operacioneve.
 - Informacioni për limitet e Kreditit.

Neni 6.3.Bordi i Njoftimeve

1. Bordi i Njoftimeve mbështet mundësinë e shkëmbimit të PTR-së së Alokuar nëpërmjet Tregut Sekondar.
2. Bordi i Njoftimeve është megjithatë vetëm një mjet për publikimin e njoftimeve. Bordi i Njoftimeve nuk është i lidhur direkt me funksionalitetet e Platformës së Ankandit (duke përjashtuar identitetin e Pjesëmarrësit në Ankand), kështu që:

- Njoftimet për gatishmërinë për të shitur apo blerë PTR-në e alokuar dhe/ose çdo informacion tjetër të publikuar nga përdoruesi i një Pjesëmarrësi në Ankand, nuk janë verifikuar nga SEE CAO dhe SEE CAO nuk merr ndonjë përgjegjësi për informacionin e publikuar në Bordin e Njoftimeve.
- Bordi i Njoftimeve as nuk e zëvendëson modulën e “Transferimit” të Platformës së Ankandit përshkruar në Paragrafin 8, as procedurën e “Rishitjes” përshkruar në Paragrafin 9. Çdo transferim i negocijuar i PTR-së së alokuar (me apo pa përdorimin e Bordit të Njoftimeve), është e vlefshme vetëm nëse njoftohet në SEE CAO nëpërmjet dhënësit dhe konfirmimet nëpërmjet Marrësit; në përputhje me Paragrafin 8 të rregullores së Ankandit.

3. Një njoftim përfshin informacionin e mëposhtëm:

- Datën e publikimit,
- Periudhën e vlefshmërisë së ofertës,
- Periudhën e rezervimit,
- Palët marrës-dhënës;
- Volumin e PTR-së;
- Identifikimin e Pjesëmarrësit në Ankand;
- Tipin e Njoftimit (blerje / shitje / të përgjithshme);
- Hapësirën për komente;
- Informacionin e kontaktit (p.sh. Një nr. Telefoni, e-mail).

4. Funksionaliteti i Bordit të Njoftimeve është i vlefshëm vetëm nëpërmjet formave të web-it (Në platformën e Ankandit), kështu që flukset korresponduese të të dhënave, nuk mund të shkëmbehen nëpërmjet shërbimeve të internetit.

5. SEE CAO përjashton çdo detyrim për çdo humbje apo dëmtim direkt, indirekt apo rrjedhimor të shkaktuar nga çdo Përdorues, lidhur me Bordin e Njoftimeve apo lidhur me përdorimin, paaftësinë në përdorim, apo rezultatet e përdorimit të Bordit të Njoftimeve, çdo website të lidhur me të dhe çdo material të postuar në të, për aq sa është e mundshme sipas ligjit në fuqi.

6. SEE CAO rezervon të drejtën të fshijë:

- Çdo lajmërim që nuk është në përputhje me objektivin e Bordit të Njoftimeve.
- Vulgaritete apo fjalë fyese për çdo Përdorues/(ë) dhe/ose person (a) të tjerë.

Vendimet për të fshirë njoftimin mund të bazohen mbi standartet etike të pranuar gjerësisht. Në rastin e çdo fshirje të tillë, SEE CAO do të japë arsytim të mjaftueshme kundrejt Pjesëmarrësit respektiv në Ankand.

Neni 6.4. Siguria dhe Mbrojta e të dhënave

1. Të dhënat tregtare që transferohen nga Përdoruesi te Platforma e Ankandit nëpërmjet internetit sigurohen nëpërmjet enkriptimit (SSL). Çdo përdorues duhet të ketë certifikatën e vetë personale për të aksesuar sistemin. Për çdo shkëmbim të dhënash biznesi, përdoret PKI standarte (Infrastruktura e Çelësit Publik). Ky mekanizëm mundëson autorizimin e transaksioneve dhe identifikimin retrospektiv të personave që futin të dhëna në Platformën e Ankandit apo që kryejnë veprime specifike. Të gjitha veprimet e bëra nëpërmjet Platformës së Ankandit janë të regjistruara me informacionin e Përdoruesit përgjegjës dhe me vulën e kohës.
2. Secili Pjesëmarrës në Ankand merr përsipër të ndjekë të gjitha rregullat e sigurisë të specifikuara në rregulloren e Ankandit. Në veçanti, Pjesëmarrësi në Ankand merr përsipër të sigurohet që:
 - Përdoruesi i Platformës së Ankandit, që ka për detyrë të dërgojë ofertat, mban çelësin e tij personal në një mënyrë që asnjë person tjetër të mos ketë akses të ky çelës;
 - Përdoruesi i Platformës së Ankandit, që ka për detyrë të dërgojë ofertat do të përdorë çelësin e tij personal dhe një certifikatë ekskluziviteti në përputhje me rregullat e ankandit për komunikim;
 - Përdoruesi i Platformës së Ankandit, që ka për detyrë të dërgojë ofertat, do të informojë SEE CAO-n menjëherë për çdo zbulim apo mundësi zbulimi të çelësit të tij personal.

Neni 6.5. Shkëmbimi i të dhënave

1. Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet Pjesëmarrësit në Ankand dhe Platformës së Ankandit të SEE CAO-s bëhet me e-mail (njoftime), uploadime apo downloadime të dokumenteve nëpërmjet Platformës së Ankandit, manualisht përmes ndërfaqes të përdoruesit në format web të Platformës së Ankandit apo duke përdorur shërbime web-i.
2. Të gjithë dokumentat që shkëmbehen duhet të jenë sipas standarteve ENTSO-E për Alokimin e Kapaciteteve dhe Nominimet ose sipas formularëve të propozuara në manualin e përdorimit të Platformës së Ankandeve ose në dokumentin e specifikimeve të Shërbimit të Web-it të cilat janë të publikuara në Platformën e Ankandeve

Paragrafi 7. Përcaktimi i Rezultateve të Proçesit të Ankandit

Neni 7.1.Rregulla të përgjithshme

1. Rezultatet e Proçesit të Ankandit përcaktohen në përputhje me parimet e mëposhtme:
 - Nëse sasia totale e ofertave të dërguara është i barabartë apo më i vogël se Kapaciteti përkatës i ofruar, Çmimi Marxhinal është zero (0) €/MWh.
 - Nëse sasia totale e gjithë ofertave të vlefshme të dërguara e tejkalon Kapacitetin përkatës të ofruar, Çmimi Marxhinal është i barabartë me çmimin e ofertës më të ulët të përzgjedhur plotësisht ose pjesërisht.
 2. Rezultatet e proçesit të ankandit për çdo produkt përcaktohen nga Platforma e Ankandit sipas Rregullores të mëposhtme:
 - a. Së pari, për secilin Produkt, Ofertat klasifikohen në renditje rënëse, bazuar në çmimet e ofertave;
 - b. Vetëm ofertat që përputhen me termat e Nenit 5.1 dhe nenit 5.6 merren në konsideratë në këtë klasifikim;
 - c. Oferta(t) me Çmimin më të lartë të ofertës përzgjidhen derisa i gjithë Kapaciteti i Ofruar nën Produktin përkatës të jetë mbaruar. Oferta, sasia e së cilës është më e madhe se Kapaciteti i Ofruar i mbetur nën Produktin përkatës, përzgjidhet pjesërisht deri në limitin e Kapacitetit të Ofruar të mbetur.
 - d. Nëse dy (2) apo më shumë Oferta të vlefshme kanë të njëjtin Çmim oferte, me një sasi të kombinuar Ofertë që tejkalon Kapacitetin e Ofruar të mbetur, këto oferta përzgjidhen pjesërisht në përpjestim me sasinë e këtyre Ofertave në njësi të rrumbullakosura deri në MW më të afërt.
 - e. Në rastin që shuma e MW nuk mund të shpërndahej në mënyrë propocionale në përputhje me Neni 7.1 Paragrafi 2d , këto MW do ti jepen ofertës më kohën më të vogël të përcaktuar nga vula e kohës.
 - f. Çmimi i Ofertës së fundit të përzgjedhur, përbën Çmimin Marxhinal.
 3. Pjesëmarrësit në Ankand, Ofertat e të cilëve janë përzgjedhur, janë informuar për rezultatet e proçesit të Ankandit dhe PTR konsiderohet të ketë qenë e rezervuar/e alokuar pjesëmarrësve të tillë të Ankandit. Në rast se proçesi i ankandit nuk është kryer me sukses, ai do të anulohet në përputhje me nenin 5.8.
-

Neni 7.2.Proçeset e Ankandit Vjetor

1. Të gjitha Ofertat të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara në Nenin 5.6, do të vlerësohen dhe Çmimi Marxhinal do të përcaktohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në Nenin 7.1.
2. Për çdo pjesëmarrës në Ankand, Vlera e totalit të Ofertave të pjesëmarrësit në Ankand, do të krahasohet me pjesën e Kufirit të Kreditit të Pjesëmarrësit në Ankand, që nuk është shfrytëzuar.
Nëse dy të dymbëdhjetat (2/12) e totalit të Vlerës së ofertave të pjesëmarrësit në ankand, në lidhje me procesin e Ankandit Vjetor të rrumbullakosura me dy (2) shifra pas presjes dhjetore, e tejkalon pjesën e Kufirit të Kreditit të pjesëmarrësit në Ankand që nuk shfrytëzohet, çdo ofertë (at) e pjesëmarrësit në Ankand, që tejkalon kufirin e kreditit, do të përjashtohet dhe nuk do të vlerësohet në procesin përkatës të Ankandit.
3. Nëse një Ofertë(t) e Pjesëmarrësit në Ankand përjashtohet(n) sipas paragrafit të mëparshëm, procedura e vlerësimit të Ofertës do të përsëritet pa Ofertat e përjashtuara në përputhje me nenin 7.1.
4. Në rastin kur Oferta(t) e Pjesëmarrësit në Ankand është (janë) përzgjedhur në Procesin e Ankandit Vjetor, një PTR e rezervuar për kombinimin marrës-dhënës është krijuar në Platformën e Ankandit.

Neni 7.3.Proçesi i Ankandit Mujor

1. Të gjitha ofertat të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara në Nenin 5.6, do të vlerësohen dhe Çmimi Marxhinal do të përcaktohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në Nenin 7.1.
2. Për çdo pjesëmarrës në Ankand, Vlera e totalit të Ofertave të Pjesëmarrësit në Ankand, do të krahasohet me pjesën e Kufirit të Kreditit të Pjesëmarrësit në Ankand, që nuk është shfrytëzuar. Nëse Vlera e totalit të Ofertave të pjesëmarrësit në Ankand, lidhur me Procesin e Ankandit Mujor, e rrumbullakosura me dy (2) numra pas presjes dhjetore, e tejkalon pjesën e Kufirit të Kreditit të Pjesëmarrësit në Ankand, që nuk është shfrytëzuar, çdo Ofertë(at) e Pjesëmarrësit në Ankand që tejkalon kufirin e kreditit do të përjashtohet dhe nuk do të vlerësohet në Procesin përkatës të Ankandit.
3. Nëse Oferta(t) e pjesëmarrësit në Ankand është (janë) të përjashtuara sipas paragrafit të mëparshëm, procedura e vlerësimit të ofertës do të përsëriten pa ofertën(at) e përjashtuar (a).
4. Në rastin kur Oferta(t) e pjesëmarrësit në Ankand është (janë) përzgjedhur në një proces ankandi mujor, një PTR e rezervuar për kombinimin Marrës-dhënës është krijuar në Platformën e Ankandit.

Neni 7.4. Proçeset e Ankandit Ditor

1. Të gjitha ofertat të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara në Nenin 5.6, do të vlerësohen dhe Çmimi Marxhinal do të përcaktohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 7.1.
2. Ofertat e dorëzuara nga pjesëmarrësi në Ankand janë pranuar veç e veç në renditje dorëzimi, deri në nivelin e Kufirit të Kreditit, që nuk është shfrytëzuar. Çdo Ofertë e dorëzuar që tejkalon kufirin e kreditit të pjesëmarrësit në ankand, që nuk është shfrytëzuar, do të përjashtohet dhe nuk duhet të vlerësohet në këtë proçes të Ankandit Ditor.
3. Në rastin kur oferta (t) e pjesëmarrësit në Ankand është (janë) përzgjedhur, në një Proçes Ankand Ditor, një PTR e alokuar për kombinimin Marrës-dhënës është krijuar në Platformën e Ankandit.

Neni 7.5. Njoftimi për Rezultatet e Ankandit

1. SEE CAO publikon rezultatet e proçesit të ankandit në faqen e internetit të SEE CAO për çdo produkt dhe kombinim Marrës-dhënës, deri në afatin e përcaktuar në kalendarin e Ankandit. Publikimi i rezultateve të proçesit të Ankandit përmban të dhënat e mëposhtme:
 - PTR totale e ofruar në MW;
 - PTR totale e rezervuar në MW;
 - PTR totale e kërkuar në MW;
 - Çmimi Marxhinal i Ankandit në €/MWh;
 - Numri i Pjesëmarrësve në Ankand që dërguan të paktën një ofertë për produktin përkatës dhe Kombinimin Marrës-dhënës;
 - Numri i Pjesëmarrësve në Ankand të shpërblyer për Produktin përkatës dhe kombinimin Marrës-dhënës;
2. Përveç kësaj, secili Pjesëmarrës Ankandi është informuar nga SEE CAO në lidhje me rezultatet e tij gjatë Proçesit të Ankandit, nëpërmjet një e-mail dhe/ose në Platformën e Ankandit, në afatin e treguar në Kalendarin e Ankandit.
3. Lajmerimi për pjesëmarrësin në Ankand në lidhje me rezultatet e tij gjatë Proçesit të Ankandit, përmban të paktën informacionin e mëposhtme: PTR-të e akorduara (me kodin CAI) për çdo produkt të Ankandit dhe Çmimin Marxhinal. Nëse Platforma e Ankandit është e padisponueshme, Pjesëmarrësit në Ankand, informohen për rezultatet e proçesit të Ankandit me e-mail ose me faks.

Neni 7.6.Kundërshtimet për Rezultatet e Ankandit

1. Një Pjesëmarrës në Ankand mund të kundërshtojë rezultatet e Proçesit të Ankandit në përputhje me afatet e mëposhtme:
 - Për proçeset e Ankandeve vjetore e mujore, jo më vonë se një (1) Ditë Pune pasi t'i jenë njoftuar rezultatet Pjesëmarrësit në Ankand;
 - Për Ankandet Ditore, jo më vonë se gjysëm ore (1/2) pasi rezultatet t'i jenë njoftuar Pjesëmarrësit në Ankand.
2. Ankimi i pjesëmarrësit në ankand duhet të shënohet si “Ankimim” dhe duhet të njotohet me email ose me Fax SEE CAO-s bashkë me konfirmimin e marrjes. Ankimi do të përmbajë:
 - Datën e ankimit
 - Identifikimin e ankandit që kundërshtohet
 - Identifikimin e pjesëmarrësit në ankand
 - Emrin, adresën e emailit dhe telefonit
 - emrin, adresa e postës elektronike (e-mail) dhe numrin e telefonit të pjesëmarrësit në ankand;
3. Përshkrime të detajuara të fakteve dhe arsyeve për kontestimin; dhe evidencë të rezultateve të pasakta të Ankandit SEE CAO do ti përgjigjet Pjesëmarrësit në Ankand brenda afateve të mëposhtë shënuara:
 - Për proçeset e Ankandeve vjetore e mujore, jo më vonë se dy (2) Ditë Pune pasi t'i jenë njoftuar rezultatet, Pjesëmarrësit në Ankand;
 - Për Ankandet Ditore, jo më vonë se një orë (1) pasi rezultatet t'i jenë njoftuar Pjesëmarrësit në Ankand.
4. Në rastin e kontestimit të suksesshëm SEE CAO do të anullojë Rezultatet e Ankandit në përputhje në nenin 5.8.
5. Në rastin e anulimit të rezultateve të Ankandit Mujor, PTR-të e alokuara të nominuara për rishitje në Proçesin e Ankandit Mujor do të kthehen te Pjesëmarrësit në Ankand që i mbajtën ato PTR.
6. Në rast të anulimit të rezultateve të Ankandit Ditor, PTR-të e alokuara të nominuara për UIOSI në Proçesin e Ankandit Ditor, do tu kompensohen me Çmimin Origjinal i Proçesit fillestar të Ankandit Mujor dhe Vjetor, Pjesëmarrësve në Ankand që i mbajtën PTR-të e alokuara.

Paragrafi 8. Transferimi i PTR-së së alokuar

Neni 8.1 Dispozita të përgjithshme

1. Transferimi i PTR-së së alokuar do të mbështetet nga platforma e ankandeve. Vetëm PTR e alokuar në ankandin mujor dhe atë vjetor mund të transferohet nga dhënësi tek marrësi. PTR e alokuar në ankandin ditor, nuk është e mundur të transferohet te pjesëmarrësit e tjerë të ankandit.
2. Të dy, si dhënësi dhe marrësi, duhet të përmbushin kushtet paraprake për të aksesuar platformën e ankandit, ashtu sikurse thuhet në nenin 6, si dhe kushtet paraprake për pjesëmarrje në procesin e ankandit për produktin.
3. Vëllimi minimal për transferim është një (1) MW gjatë një (1) ore.

Neni 8.2 Marrëveshjet financiare

1. Pjesëmarrësit në ankand, që dëshirojnë të transferojnë të gjithë ose një pjesë të PTR-së së alokuar duhet të përmbushin detyrimet e tyre financiare ndaj SEE CAO.
2. Pjesëmarrësit e ankandit mund të transferojnë PTR-në e alokuar pa asnjë tarifë shtesë.
3. Në rast të reduktimit të kapacitetit, në përputhje me nenin 2.3, rimbursimi i PTR-së së reduktuar bëhet për pjesëmarrësit në ankand, të cilët disponojnë PTR-në e alokuar në momentin e reduktimit.

Neni 8.3 Proçesi i transferimit

1. Pjesëmarrësi në ankand, i cili disponon PTR-në e alokuar, mund t'ia transferojë atë, një pjesëmarrësi tjetër në ankand nëpërmjet Platformës së Ankandit.
2. PTR e alokuar mund të transferohet në bazë orare.
3. Pjesëmarrësit e Ankandit që kanë për qëllim të transferojnë PTR-në e alokuar, mund t'ia transferojnë këtë të fundit pjesëmarrësve të tjerë në ankand, në çdo interval kohe dhe çdo sasi, nëpërmjet Platformës së Ankandeve.
4. Transferimi i PTR-së së alokuar mujore dhe vjetore duhet të konfirmohet në Platformën e Ankandit nga marrësi brenda 4 (katër) orëve që në momentin e vendosjes së ofertes dhe duke nisur të paktën nga ora 10:00 CET të D-2, në të kundërt, transferimi anulohet dhe PTR e alokuar mbetet me dhënësit. PTR e alokuar e transferuar do të marrë një kod të ri CAI nga platforma e ankandeve. I transferuari duhet të përmbushë kërkesat në përputhje me Rregulloren e Ankandit.

5. Platforma e ankandit ju siguron pjesmarrësve informacion rreth PTR-së që ju është alokuar. E gjithë historia e transferimit të PTR-së së alokuar do të ruhet në historinë e Platformës së Ankandeve.
6. Pranimi i një oferte për transferimin e PTR-së së alokuar paraqitur nga dhënësi dhe marrja e konfirmimit paraqitur nga marrësi do të rregjistrohet automatikisht në platformën e ankandit. Evidencat do të dërgohen nga dhënësi dhe marrësi.
7. Marrja e konfirmimit nga ana e marrësit (në përputhje me paragrafin 4 të paraqitur më sipër) në Platformën e Ankandit është kriteri vendimtar në përmbushjen e afatit për transferim.

Neni 8.4 Pasojat ligjore të një transferimi

1. Të dy Pjesmarrësit në Ankand, marrësi dhe dhënësi pranojnë se të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo Rregullore Ankandi (me përjashtim të detyrimit të pagesës në lidhje me ndarjen e PTR-së) janë transferuar së bashku me PTR-në e alokuar.
2. SEE CAO nuk është i detyruar të shqyrtojë nëse transferimi midis dhënësit dhe marrësit është i ligjshëm. Në çdo rast, pas konfirmimit të transferimit nga marrësi, çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet tyre nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e transferimit.

Neni 8.5 Mënyra e kthimit në kushtet fillestare për transferimin

1. Në rast se SEE CAO ka për të kaluar në kushtet fillestare për transferim, SEE CAO do të njoftojë me faks ose e-mail marrësit dhe dhënësit.
2. Në këtë rast, afati i fundit për dërgimin e lajmërimeve të transferimit është përcaktuar në nenin 8.3. (4). SEE CAO do të dërgojë pranimet ose refuzimet e operacioneve në Tregun Sekondar para orës 10:30 CET të së njëjtës dite.
3. SEE CAO nuk do të mbajë përgjegjësi për kompesim të asnjë lloji dëmi që mund rrjedhë si rezultat i shpëputjes së papritur nga Platforma e Ankandit, gjë e cila shkakton dhe pezullimin e Tregut Sekondar.

Paragrafi 9. Rikthimi i PTR-së së alokuar për rishitje

Neni 9.1 Dispozita të përgjithshme

1. Pjesmarrësit në Ankand, mbartës të PTR-së së alokuar në procesin e ankandit vjetor, mund ta rikthejnë tërësisht ose pjesërisht PTR-në e alokuar OST-ve të caktuara nëpërmjet SEE CAO-s. PTR-ja që u kthye do të jepet në Procesin e Ankandit mujor të kryer nga SEE CAO.
2. PTR e alokuar në procesin e ankandit vjetor dhe/ose mujor, që nuk është përdorur në skedulimin e nominimeve, në një moment të dytë rikthehet automatikisht nga Pjesëmarrësit e Ankandit të pjesmarrësit e OST-ve për procesin e ankandit ditor nëpërmjet SEE CAO duke përdorur parimin “Use It Or Sell It”, “Përdore ose Shite” si është përshkruar në nenin 10.3.
3. PTR e alokuar në procesin e ankandit vjetor deklaruar për rialokim në procesin e ankandit mujor duhet të jetë një grup konstant MW gjatë gjithë muajit të periudhës së alokimit në fjalë. Vlera minimale është një (1) MW gjatë një (1) muaji.
4. Rishitja e PTR-së së alokuar gjatë procesit të ankandit ditor nuk është e mundur.

Neni 9.2 Marrëveshjet financiare

1. Pjesmarrësit e ankandit që duan të rishesin PTR-në e tyre të alokuar pjesërisht ose tërësisht, duhet të përmbushin detyrimet e tyre financiare kundrejt SEE CAO si është përshkruar në nenin 15.2.

Neni 9.3 Proçesi i rishitjes

1. Pjesëmarrësit e ankandit që zotërojnë PTR-në e alokuar vjetore, kanë të drejtën e rialokimit të PTR-së së alokuar përgjatë procesit të ankandit mujor.
2. Vëllimi i PTR-së së alokuar, deklaruar për rishitje duhet të jetë grup konstant (MW) për një interval të konsideruar.
3. Njoftimi për rishitje i PTR-së së alokuar duhet të paraqitet nga rialokuesi i platformës së ankandeve, jo më vonë se ora 12:00 CET në ditën e publikimit të kapacitetit të ofruar për ankandin mujor.
4. Në qoftë se një Pjesëmarrës i Ankandit dëshiron të korrigjojë njoftimin e mëparshëm të rishitjes, ai duhet ta modifikojë lajmerimin e rishitjes nëpërmjet Platformës së Ankandeve me një volum kapaciteti të ri.

5. Marrja e konfirmimit për rishitje dorëzuar nga rialokuesi do të konfirmohet automatikisht nga SEE CAO.
6. Marrja e konfirmimit dërguar rialokuesit nga SEE CAO pas marrjes së njoftimit të rishitjes, përfshin një mesazh pranimi apo një mesazh që përcakton arsyet për refuzimin nëse rishitja është refuzuar.
7. Nëse rishitja është pranuar nga SEE CAO, PTR e alokuar reduktohet nga shuma e rishitjes.

Neni 9.4 Anullimi i rishitjes në procesin e ankandit mujor

1. Në rastin e reduktimit të PTR-së së alokuar dorëzuar për rishitje Platformës së Ankandeve, brenda afatit në përputhje me nenin 9.3 (3), SEE CAO do të anullopë të gjitha rishitjet që janë pranuar gjatë procesit të ankandit mujor për të cilat Specifikimet përfundimtare të Ankandit nuk janë publikuar ende.
2. Me këtë anulim, PTR e alokuar që është dhënë për rishitje i kthehet përsëri rialokuesit para se reduktimi të jetë aplikuar.

Neni 9.5 Kthim në kushte fillestare për rishitje

1. Në rast se SEE CAO duhet të kthehet në kushtet fillestare për rishitje, SEE CAO do ti dërgojë rialokuesit njoftim me faks ose e-mail.
2. Në rastin e kthimit në kushtet fillestare, afati përfundimtar për dërgimin e njoftimit të rishitjes, është përcaktuar në nenin 9.3 (3). SEE CAO do të dërgojë pranimet ose refuzimet e zhvillimeve në Tregun Sekondar nga ora 17:00 CET, një ditë para publikimit të Specifikimeve të Ankandit për Ankandin e caktuar mujor.
3. SEE CAO nuk do të mbajë përgjegjësi për kompesim të asnjë lloji dëmi që mund rrjedhë si rezultat i shpëputjes nga Ankandi, gjë e cila shkakton dhe pezullimin e Tregut Sekondar.

Paragrafi 10. Përdorimi i PTR së alokuar

Neni 10.1 Dispozita të përgjithshme

1. PTR e alokuar mund të përdoret nga Pjesëmarrësit e Ankandit vetëm nëse këta të fundit përmbushin kushtet për akses në rrjetin e transmetimit për një çift të

caktuar marrës-dhënës, përgjatë nominimeve të PTR-së së alokuar në procesin e skedulimit. Ky proces është i organizuar me OST-të e interesuara.

2. Pjesëmarrësi i Ankandit duhet të përmbushin kontratat përkatëse me OST-të pjesëmarrëse, gjë e cila lejon Pjesëmarrësin e Ankandit të përdorin PTR-në e alokuar (shiko Aneksi 4, shtojca 2)
3. Pjesëmarrësit e OST-ve e kanë rezervuar të drejtën e tyre për të ndryshuar kërkesat për përdorimin e PTR-së së alokuar dhe SEE CAO ka të drejtën për të përshtatur Rregulloren e Ankandit në bazë të ndryshimeve të paraqitura nga Pjesëmarrësit e OST-ve në pajtim me paragrafin 17.

Neni 10.2 Rregullat e përdorimit të kapacitetit – Skedulimi

1. Dokumenti i të drejtave të kapaciteteve duhet të përmbajë të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me volumin në MW që Pjesëmarrësit e ligjshëm në ankand duhet të nominojnë sipas çiftit marrës-dhënës. Platforma e ankandeve do të llogarisë përditë, dhe jo më vonë se 10:30 a.m të D-2 të ditës së dorëzimit të të drejtave të kapaciteteve për PTR-në e alokuar mujore dhe vjetore dhe jo më vonë se 10:30 a.m të D-1 të ditës së dorëzimit të të drejtave të kapaciteteve për PTR-në e alokuar ditore.
2. Nominimi për PTR-në e alokuar lidhur me çiftin marrës-dhënës realizohet duke i dorëzuar Programin e Shkëmbimit OST-së pjesëmarrëse si një burim për Rajon Kontrollin dhe tek OST-ja pjesëmarrëse si Rajon Kontrollues për akumulimin në procesin e skedulimit, organizuar nga OST-të pjesëmarrëse në përputhje me rregullat e tyre individuale. Nominimi në programin e shkëmbimit është bazuar në një nga principet e mëposhtme:
 - Nga A tek A: Pjesëmarrësi A i ankandit do të jetë në të dyja anët në kufirin e OST-së në fjalë.
 - Nga A tek B: Pjesëmarrësi A në ankand mund të emërojë një person juridik B në anën e OST -së importuese.
 - Nga A tek N: Pjesëmarrësi A në ankand mund të emërojë disa persona juridike N në anën e OST-së importuese

Zbatimi i këtyre parimeve do të jetë në përputhje me dokumentat e të drejtave të gjeneruara nga SEE CAO dhe rregullave të brendshme të çiftit përkatës marrës-dhënës.

3. PTR-të e alokuara mujore dhe vjetore duhet të nominohen nga Pjesmarrësit e Ankandit në procesin e skedulimit për OST-të përkatëse deri në afatën përfundimtar të përcaktuar në faqja web (www.seecao.com).
4. PTR-ja ditore e alokuar duhet të nominohet nga Pjesmarrësit e Ankandit në procesin e skedulimit për OST-të përkatëse në përputhje me rregullat e tyre individuale.

Neni 10.3 Përdore ose shite (UIOSI)

1. Përdorimi i PTR-së së alokuar dhënë në proceset e ankandëve mujore dhe vjetore është i bazuar në parimin “Përdore ose shite”. Ky parim nënkupton që PTR-të e alokuara që nuk kanë qënë nominuar në Programin e Shkëmbimit gjatë procesit të skedulimit për OST-të përkatëse janë automatikisht të rialokuara në Procesin e Ankandit ditor.
2. PTR e alokuar, e pa nominuar, dhënë në procesin e Ankandit mujor dhe atij vjetor konfirmuar nga OST-të përkatëse pjesëmarrëse, bëhen publike pasi përfundon procesi i skedulimit.
3. Një pjesëmarrës i Ankandit ka të drejtë të marrë për secilin MW, dhe për secilën orë të PTR-së së alokuar, që nuk është nominuar, dhënë në Procesin e Ankandit mujor dhe atij vjetor, një kompesim financiar të barabartë me Çmimin Marxhinal, të përcaktuar në Procesin e Ankandit ditor (përfshirë çmimin marxhinal të barabartë me 0 (zero) në rastin kur nuk ka kongjestione).
4. Në qoftë se kapaciteti i ofruar në Procesin e ankandit ditor, për shkak të kufizimeve teknike, bëhet më i ulët sesa PTR e alokuar që nuk është nominuar dhe është dhënë në Procesin e Ankandit vjetor dhe atij mujor, kjo e fundit zvogëlohet mbi një bazë proporcionale. Pjesëmarrësit e Ankandit për secilën MW të pa-nominuar do të marrin një kompesim financiar të barabartë me çmimin Marxhinal të procesit fillestar të ankandit, në të cilën PTR është alokuar për rezervim. Pjesa e PTR-së së alokuar që nuk është nominuar, dhe nuk është reduktuar do të kompensohet me çmimin marxhinal përcaktuar në Procesin e Ankandit ditor (përfshirë çmimin marxhinal të barabartë me 0 (zero) në rastin kur nuk ka kongjestion).
5. Pjesëmarrësi i interesuar i ankandit ka të drejtë të marrë për çdo MW dhe orë, një kompensim financiar të barabartë me çmimin origjinal marxhinal të ankandit fillestar në të cilin PTR ishte alokuar në rast se atë ditë procesi i ankandit është anuluar, pasi janë publikuar rezultatet paraprake. Pjesëmarrësi i këtij Ankandi ka të drejtë të marrë për secilën MW të pa-nominuar dhe secilën

orë një kompesim financiar të barabartë me Çmimin Marxhinal origjinal të procesit fillestar të ankandit në të cilën ishte alokuar PTR.

Neni 10.4 Përdorimi i PTR-ve ditore

1. PTR-të e alokuara nga procesi i ankandit ditore janë përdorur në përputhje me rregullat e tregut dhe / ose marrëveshjeve bilaterale ndërmjet OST-ve përkatëse.
2. PTR-të ditore të alokuara të cilat nuk janë nominuar në Procesin e Skedulimit nuk u kompesohen financiarisht pjesëmarrësve të caktuar të ankandit.

Paragrafi 11. Rregullat e përgjithshme për pagesat

Neni 11.1 Dispozita të përgjithshme

1. Çdo pagesë e siguruar nga CAO nëpërmjet Procesit të Ankandit, do të trajtohet si pronë përkatëse e OST-ve, pjesëmarrëse në ankand.
2. Monedha përkatëse për faturimin është euro.
3. Çmimi për rezervimin e PTR-ve, respektivisht për PTR-të e alokuara, mbulon vetëm të drejtën e përdorimit të kapacitetit të alokuar dhe nuk përfshin përdorimin e sistemit të transmetimit.
4. Pjesëmarrësit e ankandit duhet të paguajnë çmimin për PTR-të e rezervuara, respektivisht për PTR-të e alokuara tek SEE CAO, edhe nëse PTR-të e alokuara janë rishitur ose transferuar nga Pjesëmarrësit në Ankand, nëpërmjet Tregut Sekondar.
5. Vërejtjet mbi saktësinë e faturimeve/kreditit të hartuar nga SEE CAO do të bëhen brenda pesë ditëve [5] kalendarike pas datës së faturimit ose datës së kreditimit. SEE CAO është i detyruar t'i përgjigjet Pjesëmarrësit në Ankand brenda pesë ditëve [5] kalendarike pas pranimit të vërejtjeve.
6. Pretendimi i ngritur nga një Pjesëmarrës në Ankand kundër një OST-je dhe / ose SEE CAOs nuk e çliron Pjesëmarrësin e Ankandit nga detyrimi për të shlyer shumën që i detyrohet SEE CAOs.
7. Të gjithë faturat do të jenë në gjuhën angleze.

Neni 11.2. Shuma që duhet të paguhet

1. SEE CAO do t'u faturojë pjesëmarrësve të ankandit çmimin për PTR-të e rezervuara, në rast të ankandeve vjetore dhe mujore, respektivisht për PTR-të e alokuara në rastet e ankandeve ditore, duke e rrumbullakosur në dy (2) shifra pas presjes dhjetore, plus taksat, apo detyrime të tjera.

2. Të gjitha tarifat bankare do të mbulohen nga Pjesëmarrësit e Ankandit.
3. Çmimi për PTR-të e rezervuara mbulon vetëm të drejtën e përdorimit të kapacitetit të alokuar dhe nuk përfshin ndonjë taksë për sistemin e transmetimit.

Neni 11.3. Faturimi

1. Faturat në format elektronik dërgohen me e-mail, kontaktit të financës deklaruar në Aneksin 4, në datën e përcaktuar në Specifikimet e Ankandit. Subjekti i faturës është “Rezervimi i të Drejtave Fizike të Transmetimit”
2. Faturat origjinale i dërgohen Pjesëmarrësit në Ankand me postë. Pjesëmarrësi i Ankandit që është deklaruar në Aneksin 4 të Deklaratës së Pranimit mund të pranojnë fatura në format elektronik, por gjithashtu ata do të marrin faturat të printuara në letër njëherë në muaj (mujore, vjetore, ditore në një zarf)

Neni 11.4. Koha e pagesës

1. Faturat duhet t'i paguhen SEE CAO-s jo më vonë se në datën e caktuar të deklaruar në faturë; ky shërbim është pa pagesë.
2. Një ditë pas skadimit të afatit, SEE CAO ka të drejtë të ekzekutojë garancinë bankare dhe / ose depozitën.
3. SEE CAO është i detyruar të njoftojë pjesëmarrësit në ankand në rast se Garancia Bankare/ Depozita është ekzekutuar.
4. Në rast të vonesave në pagesë, kreditori (SEE CAO) ka të drejtë të ekzekutojë penalitetet e ngarkuara sipas normave të interesit mbi shumën e paguar për çdo ditë, e cila aplikohet për të gjithë periudhën e vonesës deri sa llogaria bankare e SEE CAO-s të kreditohet.
5. Norma e zbatueshme e interesit mujor (1) do të jetë EURIBOR plus një (1) pikë përqindje në vit. Këto interesa do të rriten ditë pas dite. Limiti i kredisë do të jetë i bllokuar në datën e caktuar me normë interesi fikse.
6. Informacioni rreth afateve të faturimit dhe pagesave publikohet në kalendarin për procesin e ankandit dhe pagesave të publikuara në faqen web të SEE CAO-s (www.seccao.com).

Neni 11.5. Data e pagesës dhe Informacioni mbi pagesat e pranuar

1. Data e pagesës ose shlyerja e pagesës është data në të cilën shuma e dhënë është kredituar në llogarinë bankare të SEE CAO-s.
2. Informacioni mbi pagesat e pranuar, në bazë të parimeve, përpunohet nga SEE CAO deri në 08:30 CET të ditës së nesërme, kur pagesa është realizuar në bazë të paragrafit 1. Bazuar në informacionin mbi pagesat e shlyera nga Pjesëmarrësi ne

Ankand, një pjesë lidhur me limitin e kreditit të Pjesëmarrësit në Ankand do të mundësohet nga/tek SEE CAO.

3. Në qoftë se të dhënat mbi pagesat e pranuar nuk janë ekzekutuar deri në 08:30 CET ditën e nesërme pas kryerjes së pagesës, sipas paragrafit 1, për shkak të vështirësive teknike me të cilat mund të përballlet SEE CAO, shuma e detyrimit do të konsiderohet si pagesë për të liruar pjesën e kredituar sipas kërkesës së Pjesëmarrësit në Ankand. Nëse rezulton se kushtet për ekzekutim nuk janë përmbushur, zbatohet neni 4.5.

Neni 11.6. Identifikimi i pagesës

1. Pjesëmarrësit e ankandit gjithmonë duhet të paraqesin numrin identifikues, i cili është dhe numri i faturës, kur duhet të kryejnë një pagesë.
2. Çdo pagesë identifikohet nga një numer llogarie. Pagesat do të përputhen me shumën e debitit (dmth shumës së treguar në faturë përkatëse të lëshuar).
3. Në rast se shuma e paguar ose numri i identifikimit të llogarisë ndryshon nga të dhënat e faturuara, debiti do të konsiderohet si i pashlyer deri në qartësimin përfundimtar.

Neni 11.7. Kompensimi dhe ndalesat

1. Pjesëmarrësit në Ankand nuk do t'i jepet e drejta e kompesimit të sasisë, ose e dhënies të ndonjë debiti në lidhje me detyrimet e Proçesit të Ankandit, kundër çdo kërkesë të SEE CAO-s, që rrjedhin ose jo nga Proçesi i Ankandit. Megjithatë e drejta e kompesimit nuk përjashtohet në rastin që pretendimi i Pjesëmarrësit në Ankand kundrejt SEE CAO është themeluar nga një vendim ligjërishit i detyrueshëm apo pakontestueshëm.

Neni 11.8. Modeli me TVSH

TVSH nuk do t'i faturohet Pjesëmarrësve të Ankandit nga SEE CAO në përputhje me nenin 46 pika 7 e Rregullores, në zbatimin të Ligjit të Malit të Zi mbi TVSH.

Paragrafi 12. Ankandi Vjetor – Shlyerjet Financiare

Neni 12.1 Pagesat dhe Faturimet

1. SEE CAO do të planifikojë të kryejë Proçesin e Ankandëve Vjetore, në mënyrë të tillë që rendi kronologjik i hapave të proçesit të lejojë mbledhjen e Çmimit Marxhinal dhe kështu alokimi i kapaciteteve do të mbulohet nga rezervat e

PTR-ve në kohën e duhur, para kryerjes së Proçesit të Ankandit Mijor për muajin Janar.

2. Çmimi që duhet të paguhet nga Pjesëmarrësi i Ankandit për PTR-në në Proçesin e Ankandëve Vjetore përcaktohet veçmas për secilin produkt duke shumëzuar Çmimin Marxhinal [€/MWh] me sasinë e rezervuar PTR e shprehur në MW dhe orët përkatëse të përdorimit të produktit përkatës në Proçesin Vjetor të Ankandit.
3. Për alokimin e PTR-ve në Proçesin e Ankandëve Vjetore shuma që duhet të paguhet nga Pjesëmarrësit e Ankandit përcaktohet në përputhje me Paragrafin e mëparshëm, dhe është i ndarë në dymbëdhjetë (12) këste mujore, secili nga këstet mujore është një e dymbëdhjeta (1/12) e shumës së përgjithshme, i rrumbullakosur me dy numra pas presjes dhjetore, plus aplikime taksash, detyrimesh dhe pagesash të tjera. Kësti i fundit mijor do të llogaritet si Sasia e Çmimit Total minus shuma e të gjithë kësteve të mëparshme mujore (për të shmangur gabimet e shkaktuara nga rrumbullakimet).
4. Për PTR-t e alokuar ne Proçeset e Ankandëve vjetore, kufiri i kreditit do të bllokohet nga SEE CAO deri në shumën prej dy (2) këstesh mujore të faturuara nga momenti që PTR përkatëse konsiderohet të ketë qenë e rezervuar nga Pjesëmarrësi i Ankandit dhe limiti i Kreditit do të reduktohet në përputhje me rrethanat deri në fund të vitit.
5. Faturimi bëhet nga SEE CAO, jo më vonë se dita e 10-të kalendarike, 2 muaj në avancë të muajit të përdorimit të Alokimeve të PTR-ve (përvec Janarit).
6. Data e caktuar e pagesës duhet të jetë dhjetë (10) ditë kalendarike pas datës së faturimit.
7. Çdo shumë mujore duhet të paguhet paraprakisht. Çdo shumë mujore duhet të paguhet në bazë të faturës së lëshuar nga SEE CAO. Të gjithë tarifat e bankës do të mbulohen nga Pjesëmarrësi në Ankand.
8. Në vijim të pagesave të shumave mujore, PTR-ja e rezervuar alokohet për muajin përkatës për Pjesëmarrësit e Ankandit.
9. Në qoftë së pagesa nuk është kryer në datën e caktuar, SEE CAO do të informojë brenda së njëjtës ditë pune Pjesëmarrësit e Ankandit me shkrim, me e-mail ose me faks se pagesa e faturës nuk është kredituar nga llogaria bankare e SEE CAO-s, dhe Garancia Bankare dhe /ose e Depozitave do të ekzekutohen.

Paragrafi 13. Ankandi Mijor – Shlyerjet Financiare

Neni 13.1 Pagesat dhe Faturimet

1. Çmimi që duhet të paguhet nga Pjesëmarrësit e Ankandit për PTR-të në Proçesin e Ankandëve Mujore përcaktohet veçmas për secilin Produkt duke shumëzuar Çmimin Marxhinal [€/MWh] me sasinë e rezervuar të PTR-ve e shprehur në MW dhe orët përkatëse të përdorimit të produktit përkatës në Proçesin Mujor të Ankandit.
2. Faturimi bëhet nga SEE CAO, jo më vonë se gjatë Ditës së Punës në vazhdimësi të Proçesit të Ankandit, një muaj në avancë të muajit të përdorimit të Alokimit të PTR-ve.
3. Data e caktuar e pagesës duhet të jetë dhjetë (10) ditë kalendarike pas datës së faturimit.
4. Çdo shumë mujore duhet të paguhet paraprakisht. Çdo shumë mujore duhet të paguhet në bazë të faturës të lëshuar nga SEE CAO. Të gjitha tarifat bankare do të mbulohen nga Pjesëmarrësi i Ankandit.
5. Në vijim të pagesave të shumave mujore, PTR-ja e rezervuar alokohet për muajin përkatës (për afatet shihni kalendarin – Kalendarin e Ankandëve) për Pjesëmarrësin e Ankandëve.
6. Në qoftë se pagesa nuk është kryer në datën e caktuar, SEE CAO do të informojë brenda së njëjtës ditë pune Pjesëmarrësit e Ankandit me shkrim, me e-mail ose me faks se pagesa e faturës nuk është kredituar nga llogaria bankare e SEE CAO-s, dhe Garancia Bankare dhe /ose e Depozitave do të ekzekutohen.

Paragrafi 14. Ankandi Ditor – Shlyerjet Financiare

Neni 14.1 Pagesat dhe Faturimet

1. Çmimi që duhet të paguhet nga Pjesëmarrësi i Ankandit për PTR-të e caktuara në Proçesin Ditor të ankandit përcaktohet veçmas për çdo orë duke shumëzuar Çmimin Marxhinal [€/MWh] të llogaritur sipas kësaj Rregulloreje Ankandi me PTR-në e alokuar të shprehura në MW në orën respektive. Çmimi për pjesën e PTR-ve të fituara në lidhje me Proçesin e Ankandit është llogaritur si shuma e sasive orare.
2. Çmimi i Alokimit ditor i PTR-ve do të faturohen në bazat mujore. Kjo sasi duhet të paguhet në mënyre retroaktive për muajin paraardhës.
3. Fatura lëshohet për të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga Proçeset e Ankandëve Ditore, por jo më vonë se dita e 5-të kalendarike pas muajit të përdorimit të kapacitetit për muajin përkatës (shihni Kalendarin e Ankandëve).
4. Data e caktuar e pagesës duhet të jetë dhjetë (10) ditë kalendarike pas datës së faturimit.

5. Shuma duhet të paguhet në bazë të faturës të lëshuar nga SEE CAO. Të gjithë tarifatat bankare do të mbulohen nga Pjesëmarrësi në Ankand.
6. Në qoftë se pagesa për Alokimin e PTR-së ditore për një çift marrës-dhënës nuk është pranuar në afat për muajin përkatës (shihni Kalendarin e Ankadeve) atëherë SEE CAO menjëherë ushtron Garancinë Bankare/Depozitën.
7. SEE CAO është i detyruar të njoftojë me shkrim Pjesëmarrësin e Ankandit në rast se Garancia Bankare / Depozitave është përdorur.

Paragrafi 15. Reduktimi, rialokimi dhe UIOSI e PTR-së së alokuar - Marrëveshja Financiare

Neni 15.1 Reduktimi

1. Të gjitha kostot, që vijnë si rezultat i garantimit të rimbursimit të pjesëmarrësve për PTR-të e alokuara (në rast të Reduktiveve), janë të mbuluara plotësisht nga përdorimi i të ardhurave nga kongestionet siç edhe përshkruhet në nenin 16.6 të Rregullores (EC) Nr 714/2009, sikurse është implementuar në procesin e vlerësimit të rregullatorit kombëtar.
2. Pjesëmarrësi në Ankand, PTR-et e të cilit janë reduktuar, ka të drejtën e rimbursimit për çdo MW të reduktuar të PTR-së së alokuar dhe për çdo orë të reduktimit me çmimin e barabartë me çmimin Marxhinal paguar për PTR-në e rezervuar.
3. SEE CAO do të ngrejë një çështje për rimbursimin lidhur me anulimin e PTR-ve të rezervuara, të cilat korrespondojnë me çmimin origjinal të paguar nga Pjesëmarrësi në Ankand për PTR-të origjinale të rezervuara. Në rastin kur Pjesëmarrësi i Ankandit ka disa detyrime ndaj SEE CAO-s dhe konfirmon SEE CAO-s që dëshiron të aplikojë kompesimin financiar për sa u lartpërmend, në këtë rast SEE CAO do të përgatisë pasqyrat e kompesimit financiar që do të jenë bazë për uljen e detyrimeve të Pjesëmarrësve të Ankandit kundrejt SEE CAO.
4. Gjatë procesit të regjistrimit do të përdoren Llogaria Bankare Nr., IBAN, emri dhe adresa e bankës si dhe kodi BIC/SWIFT i mundësuar nga Pjesëmarrësi në Ankand tek SEE CAO.
5. Kjo marrëveshje për rimbursimin e Pjesëmarrësve në Ankand zakonisht dërgohet në ditën e shtatë të muajit pasardhës nga SEE CAO tek Pjesëmarrësi në Ankand.

Neni 15.2. Rishitja i PTR-ve të alokuara

1. Kushti paraprak për rishitje që trajtohet nga ana e SEE CAO është marrja e pagesës së plotë për PTR-të e rezervuara që kërkohen gjatë Procesit vjetor të Ankandit duke vendosur aplikimin e Pjesëmarrësit në Ankand.

2. PTR-të e alokuara, të rishitura në një Proçes Ankandi mujor të cilat ripaguhën me çmimin marxhinal të Proçesit të Ankandit, në të cilin PTR-të u rishitën, mund të jenë zero.
3. Pjesëmarrësi në Ankand do të lëshojë një faturë në bazë të informacionit të vënë në dispozicion nga SEE CAO në Platformën e Ankandit si dhe për të gjitha rastet e kthimit që kanë ndodhur në muajin paraardhës. Informacioni i siguruar nga SEE CAO do të përmbajë një listë të PTR-ve të alokuara që janë kthyer mbrapsht për atë Pjesëmarrës në Ankand, dhe do të përcaktojë shumën e kompensimit që do të faturohet. Subjekti i faturës do të jetë "Kompensimi për rishitjen e PTR-ve të alokuara".
4. Shuma e kompensimit nga SEE CAO brenda qëllimit të rishitjes përcaktohet duke shumëzuar çmimin përkatës marxhinal [€ / MWh] me sasinë MWh të PTR-ve të alokuara të cilat do të rishiten [MW] në njësinë kohore përkatëse (ditë, orë). Ripagesa nxirret nga shuma e sasive të përcaktuara për çdo njësi të kohës.
5. Kompensimi, i cili duhet të paguhet në kontekstin e rishitjes i paguhet Pjesëmarrësit në Ankand jo më vonë se dita e 12-të e punës e muajit vijues në llogarinë e deklaruar nga Pjesëmarrësi në Ankand në Deklaratën e Pranimit (Aneks 4). Në rastin që Pjesëmarrësi në Ankand ka disa detyrime kundrejt SEE CAO-s dhe i konfirmon këtij të fundit, që do të parapëlqente të aplikojë kompesimi financiar për kompesimet e sipërmenduara, SEE CAO do të përgatisë një deklaratë kompesimi që do të ishte bazë për uljen e detyrimeve kundrejt SEE CAO-s nga ana e Pjesëmarrësit në Ankand.

Neni 15.3. Shite ose përdore(UIOSI) e PTR-ve të alokuara

1. Kushti paraprak për UIOSI që trajtohet nga ana e SEE CAO-s është marrja e pagesës së plotë për PTR-të e rezervuara që kërkohen gjatë proçesit mujor dhe vjetor të ankandit duke vendosur aplikimin e Pjesëmarrësit në Ankand.
2. PTR-të e alokuara të rishitura në një Proçes Ankandi ditor të cilat ripaguhën me çmimin marxhinal të proçesit të ankandit në të cilin PTR-et u rishitën, mund të jenë zero.
3. Pjesëmarrësi në Ankand do të lëshojë një faturë në bazë të informacionit të vënë në dispozicion nga SEE CAO në Platformën e Ankandit si dhe për të gjitha rastet e kthimit që kanë ndodhur në muajin paraardhës. Informacioni i siguruar nga SEE CAO do të përmbajë një listë të PTR-ve të alokuara që janë kthyer mbrapsht për atë Pjesëmarrës në Ankand dhe do të përcaktojë shumën e kompensimit që do të faturohet. Subjekti i faturës do të jetë "Kompensimi për UIOSI-në e PTR-së së alokuar".
Kjo faturë do t'i dërgohet SEE CAO jo më vonë se 10 ditë pune pas zhvillimit të proçesit të ankandit.
4. Shuma e kompensimit nga SEE CAO brenda intervalit të UIOSI-së, përcaktohet duke shumëzuar çmimin përkatës marxhinal [€ / MWh] me sasinë MWh të PTR-

ve të alokuara të cilët do të rishiten gjatë UIOSI-së [MW] në njësinë kohore përkatëse (ditë, orë). Ripagesa nxirret nga shuma e sasive të përcaktuara për çdo njësi të kohës.

5. Kompensimi për t'u paguar në kuptim të UIOSI i paguhet pjesëmarrësit në ankand jo më vonë se fundi i muajit pasardhës në llogarinë e deklaruar nga Pjesëmarrësi në Ankand në Deklaratën e Pranimet (Aneks 4). Në rastin që Pjesëmarrësi në Ankand ka disa detyrime kundrejt SEE CAO-s dhe i konfirmon këtij të fundit, që do të parapëlqente të aplikojë kompesimi financiar për kompesimet e sipërpërmenduar, SEE CAO do të përgatisë një deklaratë kompesimi që do të ishte bazë për uljen e detyrimeve kundrejt SEE CAO-S nga ana e pjesëmarrësit në Ankand.
6. Në rast të anulimit të Proçesit të Ankandit ditor siç përshkruhet në nenin 10.3.5, rimbursimi bëhet nëpërmjet çmimit origjinal të Proçesit të Ankandit në të cilin ajo PTR ka qenë alokuar. SEE CAO do të ngrejë një çështje për rimbursimin lidhur me anulimin e shërbimit të rezervimit, gjë e cila është e njëjtë me çmimin origjinal të paguar nga Pjesëmarrësi në Ankand për shërbimet origjinale të rezervuara.
7. Gjatë proçesit të regjistrimit do të përdoren Llogaria Bankare Nr., IBAN, emri dhe adresa e bankës si dhe kodi BIC/SWIFT i mundësuar nga pjesëmarrësi në Ankand tek SEE CAO.
8. Kjo marrëveshje për rimbursimin e pjesëmarrësve në ankand zakonisht dërgohet në ditën e shtatë(7th) të muajit pasardhës nga SEE CAO tek pjesëmarrësi në ankand.

Paragrafi 16. Pezullimi dhe ndërprerja e kontratës kornizë

Neni 16.1. Pezullimi i Kontratës Kornizë

SEE CAO mund të pezullojë përkohësisht pjesëmarrësit në Ankand

1. SEE CAO nëpërmjet një lajmërimi mund ti pezullojë përkohësisht Pjesëmarrësit në Ankand të drejtat në lidhje me këtë Rregullore Ankandi në rast se ky i fundit kryen një shkelje të madhe të detyrimeve përcaktuar në përputhje me Rregulloren e Ankandit, shkelje që mund të kenë ndikim të madh të SEE CAO dhe mund të jenë të renditura si më poshtë:

- Nëse një Pjesëmarrës në Ankand nuk kryen pagesat në përputhje me nenin 11.4
- Nëse një Pjesëmarrës në Ankand nuk arrin të sigurojë dhe mirëmbajë instrumentet e menaxhimit të rrezikut në përputhje me nenin 4.2;

- Çdo shkelje që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm financiar për SEE CAO-n;
- SEE CAO ka arsye të mjaftueshme që asnjë Pjesëmarrës në Ankand nuk i përmbush me një ose disa nga kushtet e tjera për të marrë pjesë në Proçeset e Ankandit në përputhje me këto Rregulla Ankandi vetëm nëse zbatohet ndërprerja sipas nenit 16.2.

2. Në çdo rast të një shkeljeje të vogël ndaj këtyre Rregullave të Ankandit, por pa u kufizuar në pamundësinë e Pjesëmarrësit në Ankand për të njoftuar një ndryshim në informacionin e dorëzuar në përputhje me nenin 3.1, SEE CAO mundet që nëpërmjet një njoftimi ndaj Pjesëmarrësit në Ankand, ti njoftojë që të drejtat e tij në lidhje me këtë Rregullore Ankandi mund të pezullohen nëse ky i fundit nuk do të ndreqë shkakun (arsyen) e pezullimit gjatë afatit kohor të përcaktuar në njoftim. Pezullimi hyn në fuqi kur ka përfunduar periodha e përcaktuar në njoftim për ndreqjen e shkaqeve.
3. Pasi pezullimi hyn në fuqi në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, Pjesëmarrësi në Ankand i pezulluar mund të mos marrë më pjesë në Proçesin e Ankandit, në të drejtat e Trasferimit apo në kthimin e të drejtave të transmetimit afatgjatë derisa pagesa e të drejtës së transmetimit afatgjatë të jetë shlyer plotësisht apo të jetë siguruar nga instrumenti i menaxhimit të riskut nga Pjesëmarrësi në Ankand i pezulluar. Pjesëmarrësi në Ankand i pezulluar nuk duhet të ketë të drejtën të përdorë të drejtat e transmetimit afatgjatë sipas Paragrafit 10. Për të shmangur dyshimin, të drejtat e transmetimit afatgjatë për të cilat Pjesëmarrësi në Ankand është i ndaluar të përdorë për shkak të pezullimit, mund të ofrohen nga Platforma e Ankandit në proçeset e mëvonshme të Ankandit dhe SEE CAO nuk do të kthejë kompesim për të drejtat e transmetimit afatgjatë në përputhje me Paragrafin 15.
4. SEE CAO mund të tërheqë një njoftim në paragrafët 1 ose 2 të këtij neni në çdo kohë. Duke dhënë një njoftim sipas paragrafit 1 ose 2 të këtij neni, SEE CAO mund të japë njoftim shtesë në çdo kohë në lidhje me të njëjtin event ose një event të ndryshëm pezullimi.

5. Pasi Pjesëmarrësi në Ankand ka përmbushur apo evituar ngjarjet e pezullimit sipas njoftimit dërguar nga SEE CAO, SEE CAO do të rivendosë sa më shpejt që është e mundur të drejtat Pjesëmarrësit në Ankand në mënyrë që të përdorë alokimin e të drejtave afatgjata të transmetimit dhe ti japë mundësinë për të marrë pjesë në procesin e Ankandit dhe/ose Transferimit dhe kthimit të të drejtave të transmetimit afatgjatë duke i shkruar një njoftim Pjesëmarrësit në Ankand. Nga data e rivendosjes së këtyre të drejtave, të drejtat afatgjata të transmetimit alokuar para pezullimit dhe të cilat mbeten të papërdorura mund të nominohen në rastin e të Drejtave Fizike të Transmetimit dhe Pjesëmarrësi në Ankand mund të marrë pjesë në Proceset e Ankandit dhe / ose në procesin e transferimit dhe kthimit të të drejtave të transmetimit afatgjatë për të marrë kompesim në përputhje me paragrafin 15.
6. Nëse SEE CAO jep një njoftim një Pjesëmarrësi në Ankand sipas paragrafit 1 ose 2 të këtij neni, njoftimi i pezullimit nuk e liron Pjesëmarrësin e Ankandit nga detyrimet e tij të pagesës në bazë të Paragrafit 11, duke përfshirë edhe detyrimet e tij të pagesës në lidhje me të drejtat afatgjata të transmetimit për të cilat Pjesëmarrësi i Ankandit humb të drejtën e përdorimit pajtim me paragrafin 2.

Neni 16.2. Ndërprerja e Kontratës Kornizë

1. Pjesëmarrësi në Ankand mund të kërkojë në çdo kohë SEE CAO-s të ndërpresë Kontratën Kornizë në të cilën Pjesëmarrësi në Ankand është palë. Ndërprerja do të hyjë në fuqi pas tridhjetë (30) ditëve të punës pas pranimit të kërkesës nga ana e SEE CAO dhe në qoftë se të gjitha detyrimet e papaguara pagesës janë të shlyer.
2. Pjesëmarrësi në Ankand do të ketë të drejtë ta ndërpresë Kontratën Kornizë në të cilën ai është Palë, në rast të shkeljes së një dispozite të Kontratës Kornizë nga SEE CAO, kur SEE CAO ka kryer një shkelje të madhe të një detyrimi lidhur me këtë Rregullore Ankandi ose shkelje të Kontratës Kornizë, në rastet e mëposhtme:
 - Kur SEE CAO në mënyrë të përsëritur dështon të paguajë Pjesëmarrësin e Ankand dhe shoqërohet me një impakt financiar sinjifikativ.

- Ka një shkelje të konsiderueshme të detyrimeve të konfidencialitetit në përputhje me nenin 17.5.
3. Pjesëmarrësi në Ankand duhet t'i dërgojë një njoftim SEE CAO-s duke deklaruar arsyen për ndërprerjen dhe duke i dhënë SEE CAO-s njëzet (20) ditë pune për të korrigjuar shkeljen. Nëse SEE CAO nuk do të ketë korrigjuar shkeljen brenda afatit të lartpërmendur, ndërprerja hyn në fuqi menjëherë pas përfundimit të këtij afati. Një zotërues i të drejtës së trasmetimit afatgjatë të cilit ka përfunduar Kontrata Kornizë sipas këtij paragrafi, nuk është i detyruar të paguajë kështet e mbetura për të Drejtën e Transmetimit afatgjatë dhe ka të drejtën e një rimbursimi për aq sa çdo kësht përfshin një shumë mbi përdorimin pas datës së ndërprerjes, e cila të llogaritet në përpjestim me datën që ndërprerja hyn në fuqi.
 4. Nëse ndodh ndonjë prej shkaqeve të ndërprerjes të paragrafit 3 në lidhje me një Pjesëmarrës në Ankand, SEE CAO mundet që nëpërmjet një njoftimi ndaj Pjesëmarrësit në Ankand të ndërpresë Kontratën Kornizë, duke përfshirë të drejtat e Pjesëmarrësit në Ankand të lidhura me këtë Rregullore Ankandi. Një ndërprerje sipas këtij paragrafi hyn në fuqi prej datës së njoftimit apo në çdo kohë të mëvonshme të specifikuar në të. Pjesëmarrësi në Ankand nuk mundet të hyjë në një Kontratë Kornizë në një fazë të mëvonshme me SEE CAO derisa vijojnë të qëndrojnë rrethanat e ndërprerjes apo nuk ka garanci të mjaftueshme që shkelja nuk do të ndodhë përsëri.
 5. Rastet e ndërprerjes sipas referimit të paragrafit 4 do të jenë vijueset:
 - Nëse të drejtat e Pjesëmarrësit në Ankand janë pezulluar për më shumë se tridhjetë (30) ditë pune
 - Nëse një Pjesëmarrës në Ankand nuk kualifikohet për pjesëmarrjen në ankand sipas përcaktimeve të Nenit 3.1;
 - Nëse një Pjesëmarrës në Ankand në mënyrë të përsëritur shkel këto Rregulla Ankandi apo një Kontratë Kornize, qoftë e riparueshme apo e pariparueshme shkelja.
 - Nëse një autoritet kompetent (i) përcakton se Pjesëmarrësi në Ankand ka kryer një abuzim apo akt mashtrimi dhe (ii) i kërkon SEE CAO të ndërpresë Kontratën Kornizë në të cilën ky Pjesëmarrës në Ankand është pjesë ose (iii)

pajtohet se SEE CAO ka baza të arsyeshme për të besuar se Pjesëmarrësi në Ankand ka kryer një keqpërdorim apo akt mashtues gjatë pjesëmarrjes në Proçesin e Ankandit dhe Transferimit/kthimit e të drejtës së transferimit afatgjatë; ose

- Nëse Pjesëmarrësi në Ankand ka ndërmarrë çdo veprim i cili mund të çojë në një dëmtim apo ulje të efektivitetit të Platformës së ankandit (duke nënkuptuar që një veprim i tillë konsiderohet të ndodhë në rastet e çdo sjelljeje që mund të çojë në një sulm të sistemit të informimit si, pa u limituar në, mohimit të shërbimit, spam, virus, thyerje (forca bruto), sulm Trojan Horse).

6. Pasi ndërprerja hyn në fuqi në përputhje me Paragrafët 1 deri në 5 të këtij neni dhe që prej atij momenti, Pjesëmarrësi në Ankand nuk mund të marrë më pjesë në ankand apo në transferimin dhe kthimin e të drejtave të transmetimit afatgjatë që ka fituar. Paragrafet 8.9 dhe 10 nuk duhet të zbatohen ndaj këtyre të drejtave të transmetimit të fituara (që gëzon). Për të shmangur dyshimet, të drejtat e transmetimit afatgjatë, për të cilat Pjesëmarrësi në Ankand është ndaluar t'i përdorë për shkak të ndërprerjes, mund t'i ofrohen nga SEE CAO në proçese ankandi të mëvonshme dhe SEE CAO nuk duhet të kthejë pagesën për të drejtat e transmetimit afatgjatë sipas Paragrafit 15.

7. Nderprerja e Kontratës Kornizë nuk ndikon në asnjë të drejtë dhe detyrim sipas/ose në lidhje me Kontratën Kornizë dhe me këtë Rregullore Ankandi që lindi para ndërprerjes përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë nen. Prandaj, çdo Pjesëmarrës Ankandi që i është ndërprerë Kontrata Kornizë do të mbetet përgjegjës, në bazë dhe në përputhje me Rregulloren e Ankandit, në lidhje me të gjitha të drejtat dhe detyrimet. Ky paragraf do të zbatohet pa asnjë dëm ndaj kompensimeve të tjera të disponueshme në SEE CAO sipas kësaj Rregulloreje Ankandi.

Paragrafi 17: Dispozita Të Përgjithshme

Neni 17.1.Ligji dhe Gjuha e Aplikuar

1. Kontrata Komizë vepron në përputhje me ligjin Belg, pa pasur lidhje me konfliktet e rregullave të tij ligjore siç mund të jetë e kërkuar aplikimi i ligjeve të një

juridiksioni tjetër. Për të shmangur dyshimet duhet të përjashtohet aplikimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara në Tregun Ndërkombëtar të të Mirave.

2. Pavarësisht përkthimeve që mund të bëhen, të certifikuara ose jo, gjuha e vetme e aplikueshme për interpretimin dhe aplikimin e Rregullores të Ankandit dhe Kontratës Kornizë është gjuha angleze.

Neni 17.2.Njoftimet

1. Të gjithë njoftimet, procedurat ligjore dhe komunikimet që vijnë nga/ose kanë lidhje me Rregullen e Ankandit, duhet të zhvillohen në gjuhën angleze, deri në masën e lejuar nga rregullat e politikave publike që kanë lidhje direkte ose indirekte me këto procedura.
2. Përveç rasteve të përshkruara në mënyrë eksplicite në këtë dokument ku kërkohet të veprohet ndryshe, posta elektronike (e-mail) do të konsiderohet si një mënyrë komunikimi e vlefshme. Një mesazh elektronik do të konsiderohet i dërguar me sukses në momentin që dërguesit i konfirmohet në mënyrë të demonstrueshme që marrësi ka marrë me sukses mesazhin elektronik ose nëse marrësi pranon marrjen e tij.
3. Në rast problemesh gjatë përdorimit të e-mail-it, njoftimet mund të bëhen me fax, dorazi, me korrier ose me postë; dërgimi do të konsiderohet i konfirmuar në datën e pranimit të vërtetueshëm të marrjes.
Të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera, do të jepet me letër dorazi kundrejt konfirmimit ose do të dërgohen me email të regjistruar apo korrier në rastet e mëposhtme:
 - a) Përfundimi i Kontratës Kornizë sipas Paragrafi 3 dhe Aneks 4;
 - b) Ndërprerjen e Kontratës Kornizë sipas nenit 16 dhe,
 - c) Dorëzimi i Garancisë Bankare dhe të Kontratës Depozite në përputhje me nenin 4.2.
4. Të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera do të konsiderohen se janë pranuar:
 - a) në rastin e dorëzimit me dorë, kundrejt marrjes së një konfirmimi
 - b) në rastin e ofrimit të parapaguar me postë të regjistruar, në ditën pas ditës së regjistruar të dërgimit ose,
 - c) në rastin e faksit, kundrejt një njoftimi marrjeje nga ana e pajisjeve marrëse të faksit ose,
 - d) në rastin e email-it, kur i dërgohet palës tjetër, por vetëm kundrejt marrjes së një njoftimi kërkuar dhe dërguar nga pala dërguese e e-mailit.

5. Nëse një njoftim ose komunikime të tjera merren jashtë orarit normal të punës në një Ditë Pune), ajo konsiderohet se është pranuar në hapjen e biznesit në ditën e ardhshme të punës.
6. Komunikimi i plotë me Platformën e Ankandëve do të arkivohet nga SEE CAO. Çdo Pjesëmarrës i Ankandit, ashtu si edhe SEE CAO, nuk do të kundërshtojë apo të ngrejë pretendime për pavlefshmërinë e ndonjë ankandi të zhvilluar, në përputhje me këtë Rregullore Ankandi, nëpërmjet Platformës së Ankandëve ku veprimet kryhen bazuar në formën e shkëmbimit elektronik të të dhënave.
7. Për më tepër, çdo Pjesëmarrës Ankand, si dhe SEE CAO, deklarojnë se do të marrin në konsideratë të dhënat nga databaza e SEE CAO-s si dhe/ose regjistrimet e bisedave telefonike mes SEE CAO-s dhe anëtarëve, të bëra në përputhje me këto Rregulla Ankandi, të jenë prova të besueshme, përveç kur provohet ndryshe.
8. Çdo mesazhi hyrës ose dalës do ti bashkëngjitet Vula e Kohës.
9. Stampimi i kohës përdor kohën e sistemit të Platformës së Ankandëve.

Neni 17.3. Detyrimet

1. Si pasojë ligjore e faktit se SEE CAO vepron duke përfaqësuar OST-të pjesëmarrëse, por në emër të saj dhe bazuar në Rregulloren e Ankandit, SEE CAO mbart një detyrim kontraktual drejt Pjesëmarrësve të Ankandit, kurse OST-të pjesëmarrëse mund të konsiderohen përgjegjëse vetëm për deliktin kundrejt Pjesëmarrësve në Ankand.
2. Ky nen zbatohet për dëmet që rezultojnë nga një shkelje të ndonjë dispozite të Rregullores së Ankandit. Ky nen nuk zbatohet për anulimin e një Proçesi Ankandi pas përfundimit të afateve për kontestim, nuk zbatohet as për kompensimin e UIOSI (Përdorë ose shite) në rast të anulimit të një ankandi ditor, nuk zbatohet as për reduktimin e PTR-ve të alokuara në rast të ndonjë Force Majeure ose për arsye të situatave emergjente dhe në këtë rast kapaciteti ditor i ofruar do të bëhet më i ulët se vlera mujore dhe vjetore e panominuar në proçesin e Skedulimit në përputhje me nenin 2.3. dhe nenin 10.3. Aplikimi i mekanizmave të kompensimit është e kufizuar në mënyrë rigoroze për rastet e përshkruara në Nenet e përmendura dhe nuk do të shtrihet në ndonjë shkelje të ndonjë dispozite të Rregullores së Ankandit.
3. SEE CAO do të jetë mbartës i detyrimeve kundrejt Pjesëmarrësve të Ankandit vetëm për dëmet e shkaktuara si pasojë e neglizhencës apo problemeve të qëllimshme. SEE CAO nuk do të ketë asnjë detyrim kundrejt Pjesëmarrësve të Ankandit për humbje në përfitime apo për dëmet që janë në masën e lejuar sipas ligjit në fuqi.

4. Nuk do të ketë asnjë dëmshpërblim për dëmet, përveç rasteve kur Pjesëmarrësi vërteton që dëmi është i shkaktuar në mënyrë direkte si pasojë e shkeljeve dhe vërteton se ka kryer veprime të arsyeshme për të zvogëluar ndikimin nga dëmet.
5. OST-të pjesëmarrëse dhe SEE CAO nuk janë përgjegjëse as për marrjen brenda afatit kohor të paracaktuar të ofertave dhe njoftimeve për transferim apo rishitje të kapacitetit, dhe as për rastet kur SEE CAO nuk ka të mundur të kontaktojë Pjesëmarrësit e Ankandit në rrugët e parashikuara në këtë Rregullore Ankandit.
6. Ky nen i shpëton ndërprerjes së Kontratës Kornizë të Pjesëmarrësve të Ankandit

Neni 17.4. Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kornizë

1. Asnjëra nga Palët nuk mund të transferojë, në asnjë mënyrë, asnjë të drejtë apo detyrim që dalin nga Kontrata Kornizë pa patur paraprakisht aprovimin me shkrim nga Pala tjetër duke mos ndikuar në veprimet e ndërmarra në lidhjen me Tregun Sekondar.
2. Në rast të ndryshimit të statusit ligjor të Pjesëmarrësit, si pasojë e ndonjë shkrirje të mundshme, blerjeje apo të ndonjë ndryshimi në emrin e kompanisë, ky i fundit duhet të njoftojë me anë të një letre zyrtare, së bashku me njoftimin e marrjes, sa me shpejt të jetë e mundur, minimalisht pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës efektive të ndryshimit ndryshimin e radhës.

Neni 17.5. Konfidencialiteti

1. SEE CAO është ngarkuar të përpunojë të gjithë të dhënat e Pjesëmarrësit të Ankandit dhe të Proçedurës së Ankandit dhe ti dërgojë ato OST-ve Pjesëmarrëse si dhe ti publikojë këto në përputhje me Rregulloren e Ankandit. Pjesëmarrësi i Ankandit pranon që ky informacion t'ju jepet OST-ve pjesëmarrëse dhe të bëhet publik duke zbatuar Rregulloren e Ankandit. Secila nga Palët përcakton informacionet e tjera të çfarëdo lloji që janë të disponueshme apo dhe çdo lloj suporti, konfidenciale pa kufizuar zbatimin e dispozitave të Rregullores së Ankandit.
2. Informacioni i cilësuar si konfidencial, duke mos kufizuar dispozitat ligjore dhe rregullatore, nuk duhet ti vihet në dispozicion palëve të treta pa patur paraprakisht aprovimin e dy palëve si dhe pa patur deklarinë mbi sigurinë që pala e tretë përmbush kushtet në lidhje me konfidencialitetin siç janë parashikuar në Nenin në fjalë.
3. Këto kushte nuk duhet të pengojnë:

- Përbushjen e detyrimeve për ti vënë në dispozicion organeve kompetente apo Autoriteteve Rregullatore të shteteve të përfshira në SEE CAO informacionin e nevojshëm për të zbatuar funksionet përkatëse, si dhe për të vënë në dispozicion informacionin në zbatim të ligjeve kombëtare të OST-ve pjesëmarrëse apo të legjislacionit të Bashkimit European;
 - Përbushjen e detyrimeve për të vënë në dispozicion informacionin e nevojshëm që mund të kërkohej nga gjykatat, autoritetet administrative dhe arbitrazhet;
 - Transmetimin e informacionit nga OST-të pjesëmarrëse dhe/ose nga SEE CAO me qëllim përbushjen e detyrimeve përkatëse në zbatim të kontratave dhe/ose të Rregullores mes tyre dhe OST-ve të tjera;
 - Transmetimin e informacionit nga OST-të pjesëmarrëse dhe/ose nga SEE CAO tek konsulentët (ligjor, teknik apo dhe të llojeve të tjerë) të cilët nuk janë prodhues, furnizues, ndërmjetës apo kompani që kanë lidhje me palët e përfshira. Këto konsulentë nuk duhet të punojnë për OST-të, për SEE CAO dhe/ose për ndonjë nga institucionet e përmendura më lart;
 - Komunikimin e informacionit kryesor për arsye teknike apo sigurie;
 - Publikimin e të dhënave në përputhje me ligjin në zbatim ose siç është parashikuar në Rregulloren e Ankandit.
4. Për më tepër, detyrimet që dalin nga Neni 17.5 nuk janë të zbatueshme:
- Në qoftë se Pala që merr informacionin vërteton që informacionin që ka marrë ka qenë publikisht i disponueshëm në të njëjtën kohë që ai e merr atë;
 - Në qoftë se Pala që merr informacionin vërteton që ky informacion, që nga koha që e merr atë, ka qenë i dërguar në mënyrë zyrtare nga një palë e tretë ose është bërë publikisht i disponueshëm;
 - Për informacionin e komunikuar në mënyrë konfidenciale, në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullatore, në një formë të inkuorporuar nga e cila nuk ka asnjë pikë informacioni specifik lidhur me lojtarët e tregut.
 - Për informacionin, publikimi i të cilit është kryer në mënyrë rigoroze sipas kësaj Rregulloreje të Ankandit.
5. Secila nga Palët e përfshira merr përsipër të ndërmarrë të gjithë masat e nevojshme për të siguruar që stafi i tij përbush detyrimet aktuale në lidhje me konfidencialitetin.
6. Secila nga Palët duhet të njoftojë Palën tjetër pa vonesa për çdo shkelje të detyrimeve që rrjedhin nga Neni 17.5.

7. Palët duhet të përmbushin detyrimet aktuale të konfidencialitetit përgjatë gjithë vlefshmerisë së Kontratës Komizë dhe për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh pas përfundimit të Kontratës Komizë.

Neni 17.6. Ndarja

1. Nëse ndonjë pjesë apo dispozitë e Rregullores së Ankandit dhe/ose Aneksve të saj janë ose bëhen të pavlefshme, të paligjshme, të pazbatueshme, pjesa/pjesët e mbetura do të vazhdojnë të jenë të vlefshme dhe të zbatueshme duke mos patur asnjë ndikim. Pjesët ose dispozitat e pavlefshme, të paligjshme, dhe/ose të pazbatueshme do të zëvendësohen me pjesë ose dispozita të vlefshme, të ligjshme dhe/ose të detyrueshme për të arritur sa më shumë të jetë e mundur synimet ekonomike dhe ligjore.

Neni 17.7. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Në rast të ndonjë mosmarrëveshje që lind nga/ose ka lidhje me këtë Rregullore Ankandi, Palët angazhohen të takohen për të kërkuar një zgjidhje miqësore. Për këtë qëllim, Pala kërkuese ose OST-ja i dërgon njoftim palës tjetër duke i vënë në dijeni:
 - Referencën e Kontratës Komizë; dhe
 - Arsyen e mosmarrëveshjes; dhe
 - Një propozim për një takim të ardhshëm, fizik ose jo, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes në mënyrë miqësore
2. Në qoftë se nuk arrihet asnjë marrëveshje ose nuk ka përgjigje të marra brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga data e njoftimit të lartpërmendur, Pala kërkuese mund t'ia referojë çështjen në arbitrazh në mënyrë që të zgjidhet përfundimisht në përputhje me Rregulloren e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), që duhet të zgjidhet nga tre (3) arbitër të cilët emërohen në përputhje me rregullat në fjalë. Gjuha që do të përdoret në procedurën e arbitrazhit do të jetë gjuha angleze.
3. Pjesëmarrësi i Ankandit në mënyrë të parevokueshme pranon se procedura e arbitrazhit në pritje, sipas Rregullores së Ankandit, me kërkesë të SEE CAO, mund të jetë procedurë arbitrazhi e pazgjidhur ndërmjet SEE CAO dhe OST-ve pjesëmarrëse në qoftë se të dy konfliktet janë të lidhura aq ngushtë sa është e domosdoshme për të dëgjuar dhe për të përcaktuar shmangien e riskun e papajtueshmërisë të dy procedurave të ndara.

4. Dispozitat e paragrafëve 2-3 të këtij neni 17.8 do të zbatohet për çdo mosmarrëveshje midis një Pjesëmarrësi Ankandi që ka selinë e regjistruar në Mal të Zi dhe SEE CAO në masën e lejuar sipas ligjit malazez. Në atë masë dhe për aq kohë sa ligji malazez nuk lejon dy palë, të cilët kanë selitë e tyre të regjistruara në Mal të Zi, të bien dakord për një arbitrazh ndërkombëtar, çdo mosmarrëveshje ndërmjet Pjesëmarrësit të Ankandit që ka selinë e tij të regjistruar në Mal të Zi dhe SEE CAO do të zgjidhet nga Gjykata Tregtare në Podgoricë.
5. Në rast të pagesës së vonuar, një Palë mund të sjellë procedurat gjyqësore kundër Palës tjetër, për cfarëdo shume të papaguar për më shumë se 20 (njëzet) ditë pune pas datës së përcaktuar, në përputhje me Rregulloren e Ankandit.
6. Pavarësisht çdo reference për zgjidhje miqësore, rezolutë eksperte apo arbitrazhi sipas këtij neni, Platforma e Ankandit dhe Pjesëmarrësi në Ankand do të vazhdojnë të zbatojnë detyrimet e tyre respektive sipas kësaj Rregulloreje Ankandi dhe Kontratës Kornizë të Pjesëmarrësit në Ankand.
7. Ky nen i shpëton ndërprerjes së Kontratës Kornizë të Pjesëmarrësve në Ankand.

Neni 17.8 Forcat Madhore

1. Forca Madhore nënkupton çdo ngjarje apo situatë të paparashikuar përtej kontrollit të arsyeshëm nga Pala e përfshirë dhe/ose nga një OST-ja Pjesëmarrëse, dhe jo për shkak të një dështimi të Palës dhe/ose një OST-se pjesëmarrëse në fjalë, ngjarje të cilat nuk mund të shmangen ose të tejkalohen me kujdes dhe largpamësi të arsyeshme, dhe të cilat nuk mund të zgjidhen nëpërmjet masave të ndërmarra nga pikëpamja teknike, financiare dhe/ose ekonomike. Pala dhe/ose OST-të pjesëmarrëse që janë ndikuar nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga Forca Madhore, ngjarje që ka ndodhur dhe është e verifikueshme, e ka të pamundur përkohësisht ose në mënyrë të përhershme përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara sipas termave të Rregullores së Ankandit.
2. Pala, që ndikohet nga Forca Madhore, do të njoftojë palën tjetër duke i përshkruar natyrën e Forcës Madhore dhe kohëzgjatjen e mundshme të saj. Detyrimet e prekura, detyrat dhe të drejtat e një Pale të ndikuar nga një Forcë Madhore, duhet të pezullohen që nga momenti i fillimit të ndikimit nga kjo Forcë. PTR-të e alokuara që janë paguar dhe që bëhen subjekt i Forcës Madhore do të rimbursohen për periudhën e kësaj Force Madhore.

3. Pala, në asnjë rrethanë, nuk mund të jetë përgjegjëse apo të ketë detyrime për të paguar çdo lloj kompensimi për dëmin e shkaktuar nga moszbatimi ose dështimi gjatë zbatimit të të gjithë apo një pjese të detyrimeve përkatëse, kur moszbatimi i tyre vjen si pasojë e ndikimit të Forcës Madhore.
4. Pala, e cila ndikohet nga Forca Madhore, duhet të kryejë të gjithë përpjekjet për të kufizuar pasojat dhe kohëzgjatjen e Forcës Madhore.
5. Në qoftë se një ngjarje e Forcës Madhore zgjat për më shumë se tridhjetë (30) ditë, SEE CAO mund të pezullojë nga të drejtat Pjesëmarrësin e Ankandit dhe/ose Pjesëmarrësi i Ankandit mund të kërkojë vetë tërheqjen e së drejtës së tij duke dërguar në postën e regjistruar njoftimin me shpjegimet e duhura. Tërheqja ose pezullimi i së drejtës do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit në fjalë.

Neni 17.9.Kohëzgjatja dhe Ndryshimet në Rregulloren e Ankandit

1. Rregullorja e Ankandit është me kohëzgjatje të pacaktuar dhe është subjekt i ndryshimit në përputhje me këtë nen. Kjo Rregullore Ankandi dhe çdo ndryshim i tyre propozohen nga OST-të përkatës, dhe do të konsultohen me, dhe miratuar nga autoritetet përkatëse rregullatore kombëtare. SEE CAO duhet të publikojë Rregulloren e Ankandit të ndryshuar dhe të dërgojë një lajmërim në lidhje me ndryshimet Pjesëmarrësit në Ankand pasi aprovimi/et ti jenë komunikuar SEE CAO-s.
2. Duke qënë se SEE CAO vepron në emër të OST-të pjesëmarrëse çdo modifikim i Rregullores së Ankandit do të koordinohet me OST-të pjesëmarrëse në përputhje me procedurën e rënë dakord ndërmjet OST-ve pjesëmarrëse dhe SEE CAO.
 - Pjesëmarrësi i Ankandit do të informohet paraprakisht në lidhje me çdo ndryshim të Rregullores së Ankandit duke publikuar këtë Rregullore të ndryshuar të Ankandit në faqen e internetit të SEE CAO dhe duke dërguar një e-mail Pjesëmarrësve në Ankand duke e lajmëruar për ndryshimet e mundshme.
 - Një ndryshim do të hyjë fuqi në datën dhe kohën e specifikuar në lajmërimin e ndryshimit por jo para se tridhjetë (30) ditë kalendarike pasi lajmërimi i ndryshimit ti jetë dërguar Pjesëmarrësve në Ankand nga SEE CAO.
3. Rregullat e Ankandit të ndryshuara do zbatohen për të gjithë Proçeset e Ankandit që do të zhvillohen pas aplikimit të këtyre ndryshimeve dhe hyjnë në fuqi dhe janë të detyrueshme për të gjithë Pjesëmarrësit ekzistues dhe Pjesëmarrësit e rinj në Ankand.

4. Përveç rastit kur shprehimisht thuhet ndryshe nga SEE CAO, Rregullat e ndryshuara të Ankandit do të drejtojnë të drejtat dhe detyrimet në lidhje me këto Rregulla Ankandi duke përfshirë dhe ato të përfuturat para datës së ndryshimit, por me datë dorëzimi para se ndryshimet të hyjnë në fuqi.
5. Çdo ndryshim i këtyre Rregullave të Ankandit do të zbatohen automatikisht në kontratën Kornizë midis SEE CAO-s dhe Pjesëmarrësit në Ankand, pa qenë nevoja që ky i fundit të nënshkruajë një kontratë të re por dhe pa cënuar të drejtën e Pjesëmarrësit në Ankand për të kërkuar ndërprerjen e Kontratës së tij Kornizë në përputhje me nenin 16.4 paragrafi1. Duke marrë pjesë në ankand, pasi Pjesëmarrësi në Ankand informohet në lidhje me ndryshimet dhe/ose përshtatjet e Rregullores së Ankandit dhe pasi këto ndryshime dhe/ose përshtatje të hyjnë në fuqi gjykohe se Pjesëmarrësi në Ankand ka pranuar ndryshimet, pra ka pranuar versionin e vlefshëm dhe efektiv të Rregullores së Ankandit.
6. Para dorëzimit të ndonjë ndryshimi(esh) të rëndësishëm të Rregullores së Ankandit tek autoritetet kompetente përkatëse, OST-të pjesëmarrëse do të ofrojnë një mundësi për Pjesëmarrësit e Ankandit, që në çdo rast do jetë jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë pune, për të rishikuar dhe të dhënë komente me shkrim në lidhje me ndryshimin/et e propozuar. Versioni përfundimtar i ndryshimit/eve të Rregullores së Ankandit merr parasysh, sa më shumë të jetë e mundur, rezultatet nga konsultimet e Pjesëmarrësve.
7. Për të shmangur problemet në lidhje me abuzimin e mundshëm nga pozita dominuese e ndonjë lojtari tregu, Komisioni Evropian apo autoritetet përkatëse rregullatore dhe/ose të konkurrencës, mund të vendosin, me vendim të përbashkët, kufizime të tjera në përgjithësi ose në një kompani individuale për shkak të dominimit të tregut. Autoritetet përkatëse rregullatore dhe/ose të konkurrencës janë autoritetet e vendeve të rajonit të Evropës Juglindore (shih Rregullorja 714/2009/EC). SEE CAO rezervon të drejtën për të futur kufizime të tilla gjatë vitit. Çdo kufizim i tillë duhet të publikohet në faqen e internetit të SEE CAO të pakten tridhjetë (30) ditë kalendarike para se ndryshimet të hyjnë në fuqi.

Neni 17.10. Anekset

Anekset e mëposhtme janë pjesë përbërëse e Rregullore të Ankandit

Aneksi [1](#) Adresa e SEE CAO

Aneksi 2. Lista e OST-ve pjesëmarrëse në SEE CAO

Aneksi 3. Lista e çifteve Dhënës-Marrës

Aneksi 4. Deklarata e Pranimit

Aneksi 5. Rregjistrimi në Platformën e Ankandit

Aneksi 6. Garancia Bankare – Kërkesat

Aneksi 7. Depozita e Kontrates

Aneks 1. Adresa e SEE CAO

Informacioni lidhur me adresën dhe detajet e kontaktit të SEE CAO janë disponibël në faqen e internetit: www.seecao.com

Aneks 2. Lista e OST-ve Pjesmarrëse në SEE CAO

Kompania (OST)	Emërtimi, Adresa (elektronike)
HOPS	Operatori i Sistemit të Transmetimit të Kroacisë, Ltd. www.hops.hr
NOS BiH	Operatori i Sistemit të Transmetimit të Bosnjë-Hercegovinë. www.nosbih.ba
CGES	Operatori i Sistemit të Transmetimit të Mali i Zi, AD. www.cges.me
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë, sh.a. www.ost.al
KOSTT	Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu KOSTT sh.a www.kostt.com
ADMIE	Operatori Independent i Sistemit të Transmetimit të Greqisë, S.A www.admie.gr
TEİAŞ	Operatori i Sistemit të Transmetimit të Turqisë, A.Ş www.teias.gov.tr
MEPSO	Македонски електропреносен систем оператор http://mepso.com.mk/

Aneksi 3. Lista e çifteve Dhënës - Marrës

#	Çiftet Dhënës – Marrës	Korniza (alokimit)	Korniza kohore	Zona orare
1.	HOPS < > NOS BiH	i përbashkët	Y/M/D	CET
2.	NOS BiH < > CGES	i përbashkët	Y/M/D	CET
3.	CGES < > OST	i përbashkët	Y/M/D	CET
4.	CGES < > KOSTT	i përbashkët	Y/M/D	CET
5.	OST < > KOSTT	i përbashkët	Y/M/D	CET
6.	IPTO < > OST	i përbashkët	Y/M/D	CET
7.	TEIAS < > IPTO	i përbashkët	Y/M/D	CET
8.	IPTO < > MEPSO 3	i përbashkët	Y/M/D	CET

Y/M/D = Vjetore/Mujore/Ditore

Aneksi 4. Deklarata e Pranimiit Për Proçesin e Ankandit në SEE CAO

Informacion i Përgjithshëm:

Emri i kompanisë: _____
Adresa: _____
Numri i regjistrimit
të biznesit: _____
Kodi fiskal: _____
Numri Tatimor _____
Përfaqësuesi Legal: _____
Numri i telefonit: _____
Numri i faksit: _____
Kodi EIC: _____

Neni 1.Deklarata

Me nënshkrimin dhe me dërgimin e kësaj Deklarate të Pranimiit, Pjesëmarrësi i Tregut deklaron përmbushjen e të gjitha kërkesave të pjesëmarrjes dhe angazhohet që t'i përmbahet këtyre Rregullave Ankandi për alokimin e kapaciteteve në SEE CAO (me poshtë Rregullorja e Ankandit) dhe Anekseve, të cilat janë publikuar në adresën www.seecao.com.

Me ofrimin e kësaj Deklarate Pranimi të nënshkruar, Pjesëmarrësi i Tregut deklaron se Deklarata e Pranimiit dhe Anekset e saj përmbajnë informacion të plotë dhe të vërtetë. Me ofrimin e kësaj Deklarate Pranimi të nënshkruar, Pjesëmarrës i Tregut deklaron se çdo ndryshim i bërë në bazë të nenit 17.10 është pranuar nga Pjesëmarrësi i Tregut, pa qënë nevoja për ndonjë njoftim shtesë.

Neni 2.Regjistrimi

Deklarata e Pranimiit duhet të dorëzohet në dy kopje të printuara në SEE CAO së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para pjesëmarrjes së parë në Proçesin e Ankandit. Deklarata duhet të jetë me shkrim, e plotësuar në mënyrë të rregullt dhe e nënshkruar. Duhet të dërgohet vetëm me postë ose personalisht në SEE CAO, në të gjitha ditët e punës ndërmjet orës 08:00 dhe 16:00. Deklarata e Pranimiit e dërguar në SEE CAO me e-mail ose fax nuk do të merret në konsideratë.

SEE CAO do të konfirmojë ose refuzojë regjistrimin duke i dërguar një shënim Pjesëmarrësit të Tregut jo më vonë se dy (2) ditë pune pasi ka marrë Deklaratën e Pranimiit. Konfirmimi ose refuzimi do të dërgohet me e-mail në adresën e dhënë në Deklaratën e Pranimiit për gjithë korrrespondencën siguruar në Deklaratën e Pranimiit.

Konfirmimi ose refuzimi në origjinal do të dërgohen nga SEE CAO me postë të regjistruar jo më vonë se dy (2) ditë pune pas konfirmimit ose refuzimit të dërguar me e-mail. Në rastin e një konfirmimi, SEE CAO do të dërgojë Pjesëmarrësve të Tregut një Deklaratë Pranimi nënshkruar nga SEE CAO. Me dërgimin e konfirmimit Pjesëmarrësit të Tregut, ky i fundit është i regjistruar dhe fiton të drejtën për të marrë pjesë në Proçesin e Ankandit si Pjesëmarrës Ankandi. Në rast se SEE CAO refuzon regjistrimin, arsyeja (et) do të thuhet në shënimin refuzimit.

Neni 3. Shqyrtimi i Deklaratës së Pranimi

SEE CAO mund të verifikojë informacionin e dhënë në Deklaratën e Pranimi dhe në Aneks bashkëngjitur.

SEE CAO ka të drejtë të refuzojë regjistrimin e pjesëmarrësve të tregut në rast të mospërputhjeve dhe/ose shtrembërimeve në Deklaratën e Pranimi.

SEE CAO ka të drejtë të kërkojë me shkrim për një apdeitim ose riparimitin e ndonjë pjesë të dokumentacionit të regjistrimit.

Neni 4. Pasojat juridike të Regjistrimit

Dorëzimi i kompletuar siç duhet dhe i nënshkruar i Deklaratës së Pranimi me gjithë shtojcat e kërkuara, që është për t'u konfirmuar nga SEE CAO, krijon një Kontratë Kornizë ndërmjet SEE CAO dhe Pjesëmarrësit në Ankand. Rregullorja e Ankandit përbën një pjesë integrale të kësaj Kontrate Kornize dhe për këtë arsye janë bazë kontraktuale për Proçeset e Ankandit.

Kjo Kontratë Kornizë është e vlefshme për një numër të pacaktuar të Proçeseve të Ankandit. Kjo Kontratë Kornizë mund të përfundojë në pajtim me Paragrafin 16 të Rregullores së Ankandit.

Neni 5. Shtojca

Deklarata e Pranimi është e plotë vetëm nëse dokumentet e mëposhtme janë bashkëngjitur:

1. Origjinali ose kopje e vërtetuar e një ekstrakti nga Regjistri Komercial / Kompanisë së bashku me një përkthim të certifikuar në anglisht i cili është jo më i vjetër se 3 muaj.
2. Një listë e përfaqësuesve të autorizuar të cilët kanë të drejtë të komunikojnë me SEE CAO në emër të Pjesëmarrësit në Ankand dhe që kanë të drejtë për të ekzekutuar deklaratat ligjërisht detyruese ndaj SEE CAO të cilat lidhen me Pjesëmarrësin në Ankand (shih Shtojcën 4.1)

Çdo Deklaratë Pranimi e dorëzuar në SEE CAO pa shtojcat e përmendura më lart, bashkëngjitur, nuk do të merren parasysh dhe nuk do të krijojnë marrëdhënie kontraktuale në mes të pjesëmarrësit në ankand dhe SEE CAO siç shpjegohet në nenin 4 më lart.

Për Pjesmarrësin në Ankand:
Emri dhe pozicioni i përfaqësuesit legal

Firma: _____
Datë: _____

Për SEE CAO:
Emri dhe pozicioni i përfaqësuesit legal

Firma: _____
Datë: _____

Shtojca 4.1. Detajet e kontaktit të Pjesmarrësit në Ankand

Detajet e kontaktit për gjithë korespondencën:

Personi kontaktit:	
Adresa:	
Telefon:	
Faks:	
E-mail:	

Kontakti Operativ:

Personi kontaktit:	
Adresa:	
Telefon:	
Faks:	
E-mail:	

Kontakti Financiar:

Personi kontaktit:	
Adresa:	
Telefon:	
Faks:	
E-mail:	

Detajet Bankare:

Banka:	
Banka ndërmjetëse:	
Mbajtësi i Llogarisë:	
Numri i Llogarisë:	
SWIFT Code:	
IBAN Code:	

- ☐ Kompania mund të pranojë fatura të dërguara me E-mail direkt nga Platforma e Ankandit, e pa firmosur,

Shtojca 4.2.Përcaktimi i dokumenteve kontraktuale

Për pjesëmarrje në ankandet vjetore, mujore, ditore, dhe në Tregun Sekondar dhe përdorimin e kapacitetit të alokuar, Pjesëmarrësi në Ankand, deklaron se ka nënshkruar të paktën një nga dokumentet e mëposhtme:

- ☐ Një kontratë të vlefshme dhe efektive për balancimin e energjisë, nënshkruar me HOPS (Pjesëmarrësi i Ankandit duhet të njihet si Palë Përgjegjëse Balancuese në Kroaci) dhe kontratë valide të nënshkruar me Operatorin e Tregut të Energjisë Kroate;
- ☐ të gjitha kontratat përkatëse të konkluduara me NOS BiH, duke përfshirë kontratat për hyrje në rrjet dhe për transmetim;
- ☐ të gjitha kontratat përkatëse të konkluduara me CGES, duke përfshirë kontratat për hyrje në rrjet dhe për transmetim;
- ☐ të gjitha kontratat përkatëse të konkluduara me OST, duke përfshirë kontratat për hyrje në rrjet dhe për transmetim;
- ☐ të gjitha kontratat përkatëse të konkluduara me KOSTT, duke përfshirë kontratat për hyrje në rrjet dhe për transmetim;
- ☐ një kontratë e konkluduar për transaksionet e ditës në avancë, me Operatorin e Tregut, LAGIE(Operatori i Tregut të Energjisë Elektrike S.A) dhe me Operatorin e Transmetimit ADMIE
- ☐ të gjitha kontratat përkatëse të konkluduara me TEIAS, duke përfshirë kontratat për hyrje në rrjet dhe për transmetim;
- ☐ përfshirë të gjitha kontratat me MEPSO, duke përfshirë kontratat për akses në rrjet dhe për transmetimin.

Aneksi 5. Regjistrimi në Platformën e Ankandit

Pjesmarrësi në Ankand

Emri i plotë:	
Kodi EIC:	
Përson i autorizuar:	

Pjesmarrësi në Ankand kërkon:

- ☐ setup (instalim)
- ☐ modifikim
- ☐ fshirje

Të një llogarie përdoruesi të Platformës së Ankandit, për përfaqësuesit e mëposhtëm të Pjesmarrësit në Ankand:

Përdoruesi

Emri, Mbiemri:	
E-mail:	
Telefon:	
Certifikate No:	
Autoriteti që e lëshon:	<u>Pošta CG</u>
E vlefshme deri:	

Në bazë të Rregullores së Ankandit, përmbajtja e të ciles është e njohur për Përdoruesin e lartpërmendur, Përdoruesi është i autorizuar për të kryer operacione në Platformën e Ankand në përputhje me të drejtat e Përdoruesve, dhe në një rast të tillë, përfaqëson Pjesëmarrësin e Ankandit të specifikuar më sipër. Informacioni hyrës (username dhe password) do të dërgohet tek Përdoruesi me e-mail e lartpërmendur, dhe ai është i detyruar të ndryshojë fjalëkalimin gjatë hyrjes së tij të parë.

Datë _____

Personi i Autorizuar i Pjesmarrësit në Ankand

Përdoruesi

Aneksi 6. Garancia Bankare - Kërkesat

Në pajtim me nenin 4.2, SEE CAO do të pranojë garanci bankare me kushtet e përcaktuara më poshtë.

Cilësia e garancisë bankare.

Banka që lëshon garanci në favor të SEE CAO (dmth garancinë bankare) ose grupi financiar, që i takon garancia bankare, duhet të jenë në përputhje me të paktën një nga kushtet e mëposhtme në lidhje me normën e saj afatgjatë të kreditit:

- a) Moody's - minimum "Baa3",
- b) Fitch/IBCA – minimum "BBB-",
- c) Standard & Poor's – minimum "BBB-".

Kërkesat lidhur me formën e garancisë

Garancia duhet të jetë e shkruar në anglisht (letter of guarantee)

Të dhënat e kërkuara në letrën e garancisë

Të dhënat e mëposhtme duhet të deklarohen në letrën e garancisë:

- një shumë e veçantë, dmth shuma maksimale që tërhiqet,
- Valuta, domethënë EUR,
- Llogaria e përfituesit (SEE CAO), ku do të paguhet, dmth, llogaria rrjedhëse nr.
- Numri (IBAN) i Përfituesit:
- Adresa e Bankës së përfituesit:
- Identifikimi i saktë i garancisë bankare,
- Përfituesi: [shkruani emrin e plotë të SEE CAO] regjistruar në regjistrin tregtar në në Regjistrin Qendror të kompanive në mal të Zi sipas: 5-0635601/002
- Identifikimi i saktë i kryesuesëve (emri, adresa, Nr. regjistri tregtar/kompanisë etj),
- Ajo mund të përmbajë një referencë në Rregulloren Uniform për Garancitë e kërkesës (nr 758.) të lëshuara nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë në Paris - megjithatë, nëse po, referenca nuk mund të bëhet me Nenin 15 të Rregullore Uniform për Garancitë "Kërkesat për kërkesën ", dmth Neni 15 nuk do të zbatohet, dhe duhet të theksohet në mënyrë të qartë në letrën e garancisë,
- Koha e vlefshmërisë së garancisë - kjo është e përcaktuar nga pjesëmarrësi në mënyrë të përshtatshme në lidhje me kërkesat e mëposhtme. Vlefshmëria e garancisë duhet të jetë të paktën 10 ditë kalendarike pas datës së faturës së fundit Procesit të Ankandit të treguar në Kalendarin e Ankandeve.
- Efektiviteti i garancisë, i cili është dhënë nga data e lëshimit,

- Kushtet për një ushtrim të garancisë bankare, në mënyrë të veçantë:
 - disbursim me kërkesën e parë (në çast) pa ndonjë kundërshtim, vetëm nr SWIFT
 - të jetë e pakthyeshme,
 - të jetë e pakushtëzuar,
 - të jetë e pa transferueshme.
- Një formë e ushtrimit të përfituesit të garancisë (bankare), është një SWIFT me formulim të plotë dhe npr Bankës ndërmjetëse duke konfirmuar që nënshkrimi i kërkesës të shfaqet konform me ekzemplarën e mbajtur nga banka.
- Të dhëna se një përmbushje e pjesshme dhe e shumëfishte është e lejuar, deri në sasinë maksimale të shumës.

Dispozita të paautorizuara

Ndër të tjera, garancia bankare nuk mund të përmbajë:

- Kushte që janë në kundërshtim me kërkesat e përfituesit për letrën e garancisë,
- Kushte që në mënyrë të konsiderueshme do të modifikojnë kërkesat e përfituesit në lidhje me letrën e garancisë,
- Çdo gjë tjetër përveç kushteve të përcaktuara për ushtrimin e garancisë bankare.

Shtojca 6.1. Garancia Bankare

SEE CAO Zyra e Ankandeve të Koordinuara për Europën Juglindore

Moskovska 39

81000 Podgorica

Montenegro

Numri i Regjistrimit Komercial: 5-0635601/002

TAX ID: 02890909

VAT ID: 30/31-11585-9

Garancia Bankare Nr

Ne jemi të informuar se emri i kompanisë, adresa ("kryesi") do të marrë pjesë në "ankandin e koordinuar të kapaciteteve transmetuese në rajonin SEE" realizuar nga ju ("Procesi i Ankandit").

Detyrim i kryesit që rezultonë nga pjesëmarrja e tij në procesin e ankandit është që të sigurohet nga një garanci bankare.

Me udhëzimet e kryesit Ne, Emri i Bankës, adresa, Id. Nr, regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës Vendore në, me anë të kësaj, japim në favorin tuaj një garanci të parevokueshme dhe të pakushtëzuar deri në shumën maksimale prej...

EUR 00.000,00

Me fjalë: EURO

dhe zotohemi t'ju paguajmë me marrjen nga ne të kërkesës tuaj të parë me shkrim, pa vonesë ose kundërshtim për llogarinë tuaj Nr .01-501-0004349.3

....., IBAN: ME25550015010004349346, mbajtur nga Societe Generale Banka Montenegro AD,, Podgorica, Mal i Zi (SWIFT: PDBPMEPG), çdo shumë apo shumat deri në shumën totale të garantuar nga ne, me kusht që një kërkesë e tillë të jetë në përputhje me të gjitha termat dhe kushtet e kësaj garancie bankare dhe përmban deklaratën tuaj me shkrim në të cilën kryesi emri i kompanisë, adresa kërkesa juaj ka të bëjë ("kërkesa").

Kërkesa juaj drejtuar tek Ne në Emri i Bankës, adresa, SWIFT..... do të dorëzohet tek Ne jo më vonë se data e skadimit të përmendur më poshtë në këtë garanci.

Kërkesa juaj në lidhje me garancinë tonë do të dergohet vetëm me SWIFT me formulim të plotë dhe npr Bankes ndërmjetese duke konfirmuar që nënshkrimi i kërkesës të shfaqet konform me ekzemplarin e mbajtur nga banka..

Shuma e garancisë tonë do të ulet me çdo pagesë të bërë nga ne nën të.Garancia pushon së qeni e vlefshme me pagesën e shumës totale të garantuar nga ne.

Kjo garanci do të hyjë në fuqi në datën e lëshimit të saj dhe është e vlefshme deridata, koha përfshirë.

Pas kalimit të datës, garancia jonë pushon së vlejture.

Kjo garanci gjithashtu pushon së vlejture pas kalimit të datës së marrjes nga Ne (kthimit tek ne) të kësaj Garancie Bankare origjinale, me kusht që një kthim i tillë të bëhet përpara datës së shprehur të skadimit të kësaj garancie.

Kjo garanci nuk është e tjetërsueshme.

Kjo garanci do të drejtohet nga ligjet e ... [dhe do të jetë subjekt i Rregullore Uniform për Kerkesën e Garancisë, botuar në nr 758 nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë në Paris, përveç sa u tha më lart, dmth në veçanti nenin 15 të Rregullore Uniform për Garancitë, nuk zbatohet].

Kthimi i origjinalit të kësaj garancie bankare tek Ne është kërkuar pas skadimit të saj.

Të gjitha tarifat e bankes tuaj janë në llogari të aplikantit

Aneksi 7. Kontrata Depozitë

Realizuar në Podgoricë, Mal i Zi, më _____midis:

_____ (Emri Pjesëmarrësit në Treg) me zyrën e regjistruar në
_____ (Adresa e Pjesëmarrësit në Treg) Nr. Tatimor
_____, VAT No _____ (Pjesëmarrësi
në Ankand) Përfaqësuar nga _____ (vendos emrin
dhe pozicionin që keni në kompani),
dhe Zyra e Koordinimit të Ankandeve në Europën Juglindore doo Podgorica, me
zyrën e regjistruar në Moskovska 39, Podgorica, Mal i Zi, Nr. Tatimor 02890909,
TVSH 30/31-11585-9 (SEE CAO), Përfaqësuar nga: Aleksandar Mijušković, Drejtor
Ekzekutiv.

Palët nënshkruese bien dakort si më poshtë:

Neni 1

Pjesëmarrësi në Ankand është i detyruar për të transferuar shumën prej EUR
_____ (sasia e depozitës) SEE CAO-s. Llogaria ndërkombëtare me qëllim të
veçantë, si menaxhimi i riskut të instrumenteve të Depozitave, në përputhje me nenet
4.1.2 dhe 4.2.1, nën pikën (a) të Rregullores së Ankandit për alokimin e kapaciteteve
në SEE CAO.

Neni 2

Në pajtim me Paragrafin 4 të Rregullores së Ankandit për alokimin e kapaciteteve në
SEE CAO çdo pjesëmarrës në treg që dëshiron të njihet si Pjesëmarrës në Ankand do
të sigurojë depozitën si një instrument të menaxhimit të rrezikut në përputhje me sa
më poshtë:

- Një Depozita ofruar nga Pjesëmarrësi në Ankand për llogari të veçantë bankare të SEE CAO-s.
- Depozita do të menaxhohet, kontrollohet dhe drejtohet ekskluzivisht nga SEE CAO.
- Çdo tarifë bankare apo interesat relative të Depozitave duhet të përballohen nga Pjesëmarrësit në Ankand.
- SEE CAO ka të drejtë të përdorë Depozitën në lidhje me kapacitetet e alokuara në rast të mospagesës
- Shuma e depozitës do të marrë parasysh limitin e kreditit dhe do të bllokohet në bazë të nenit 4.5 të Rregullores së Ankandit
- Pjesëmarrësi në Ankand ka të drejtë të marrë interesa për depozitim kredituar në llogarinë bankare të SEE CAO-s në shumën e përcaktuar nga një dekret përkatës në lidhje me normat e interesit të lëshuara nga banka ku Depozita është vendosur.

- Kjo Depozitë mund të shërbejë vetëm si një instrument i menaxhimit të rrezikut dhe nuk do të përdoret si paradhënie.

Neni 3

Depozita e referuar ne Nenin 1 të kësaj kontrate do të jetë për një periudhë prej _____ vitesh (muajsh) nga data e pagesës.

Neni 4

Depozita mund të zëvendësohet ose të zgjatet me një depozitë shtesë.

Depozitat të cilat nuk janë shfrytëzuar dhe/ose të cilat nuk janë ushtruar do ti kthehen në bazë të kërkesës me shkrim Pjesëmarrësit në Ankand jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendarike pas pranimit të kërkesës.

Kërkesa për kthimin e Depozitave do të përmbajë detajet e mëposhtme të pagesës: Shuma e Depozitave për t'u kthyer, nr i llogarisë bankare, IBAN, emri dhe adresa e bankës dhe BIC/kodi SWIFT.

Neni 5

SEE CAO mund të përdorë këtë depozitë në pajtim me Rregulloren e ankandit për alokimin e kapaciteteve në SEE CAO.

Pjesëmarrësi në Ankand revokon të drejtën e tij te kundërshtimit nëse SEE CAO përdor depozitën për zgjidhjen e pretendimeve në përputhje me këtë Kontratë dhe Rregulloren e Ankandit për alokimin e kapaciteteve në SEE CAO.

Neni 6

Dispozitat e Rregullore së Ankandit për alokimin e kapaciteteve në SEE CAO në qoftë se nuk janë të përmendura këtu janë detyruese për këtë kontratë.

Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet dispozitave të kësaj Kontrate dhe Rregullore së Ankandit për alokimin e kapaciteteve në SEE CAO, ajo që do të merret parasysh është kjo kontratë.

Neni 7

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me këtë kontratë, Gjykata Ekonomike në Podgoricë, Mali i Zi do të jetë përgjegjëse për zgjidhjen e tij.

Neni 8

Kjo kontratë është bërë në 4 (katër) kopje identike, dy prej të cilave do ti mbajë pjesëmarrësi në ankand dhe dy do ti mbajë SEE CAO.

SEE CAO

Pjesmarrësi në Ankand